

1 E hënë, 10 nëntor 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 14.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare e seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Së pari, vërej që të akuzuarit janë të gjithë të
13 pranishëm në sallën e gjyqit sot. Sot do të fillojmë me
14 dëshminë e Dëshmitarit të Mbrojtjes së Thaçit 1DW-008.

15 Përpara se të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit të
16 Mbrojtjes, dëshirojmë që të trajtojmë një çështje paraprake.

17 Trupi Gjykses vëren se në parashtimin e protokolluar
18 F03569, Mbrojtja e Thaçit kërkoi së pari përshpejtimin e
19 afatit për parashtimin dhe, së dyti, leje për ndryshimin e
20 listës së provave materiale për të shtuar një dokument që
21 synon që të përdorë me Dëshmitarin 1DW-008.

22 ZPS-ja u përgjigj që ajo nuk kishte kundërshtime për
23 kërkesën.

24 Së pari, Trupi Gjykses vëren që e përshpejtoi afatin për
25 kërkesën në fjalë të premtën -- ta them dhe një herë. Trupi

1 Gjykues e përshpejtoi afatin për kërkesën më 7 nëntor 2025,
2 ditë e premte.

3 Së dyti, në lidhje me kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për
4 të shtuar një video të një konference për shtyp të Dëshmitarit
5 1DW-008 dhe transkriptet përkuese në listën e provave
6 materiale, Trupi Gjykues vëren se, së pari, Mbrojtja është
7 nxjerrë më 16 tetor 2025 dhe, së dyti, Mbrojtja e Thaçit ka
8 pasur mundësi që të vlerësojë nevojën për pranimin në prova të
9 kësaj videoje në seancën përgatitore të organizuar me
10 Dëshmitarin 1DW-008 në mbrëmjen e 5 nëntorit 2025. Trupi
11 Gjykues rikujton se rëndësia e dokumenteve të caktuara mund të
12 bëhet e dukshme për një palë të caktuar gjatë procesit të
13 gjyimit. Gjithashtu, Trupi Gjykues vëren se Mbrojtja e Thaçit
14 e ka bërë kërkesën dy ditë pasi e ka kuptuar rëndësinë e
15 dokumentit në fjalë. Për rrjedhojë, Trupi Gjykues konstaton se
16 Mbrojtja e Thaçit ka bërë njoftim në kohë.

17 Trupi Gjykues vëren se dokumenti ka të bëjë me
18 ndërveprimet e dëshmitarit me UÇK-në dhe konstatimet e tij
19 lidhur me nivelin e organizimit dhe komandës dhe kontrollit të
20 UÇK-së në vitin 1998. Këto janë tema që kanë rëndësi për
21 akuzat në aktakuzë. Për rrjedhojë, Trupi Gjykues konstaton se
22 materiali ka rëndësi *prima facie*, ka rëndësi të mjaftueshme
23 dhe se ekzistojnë shkaqe bindëse për sa i takon pranimin me
24 vonesë të këtij dokumenti në listën e provave materiale.

25 Së fundi, sa i takon efektin dëmtues, Trupi Gjykues vëren

1 se kërkesa është e kufizuar në fushëveprim pasi Mbrojtja e
2 Thaçit synon që të përdorë vetëm një minutë të videos.
3 Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja nuk kundërshton për
4 shtimin e këtij dokumenti në listën e provave materiale. Duke
5 marrë parasysh se palët dhe pjesëmarrësit kanë pasur kohë të
6 mjaftueshme për të rishikuar dhe analizuar siç duhet videon
7 dhe për t'u përgatitur për Dëshmitarin 1DW-008, Trupi Gjykses
8 konstaton se nuk ka asnjë efekt dëmtues sa i takon shtimit të
9 videos dhe transkriptove përkatëse në listën e provave
10 material.

11 Trupi Gjykses miraton kërkesën për shtimin e dokumentit
12 129503-12 dhe 129503-12-TR-ET, si dhe përkthimet përkuese, në
13 listën e provave materiale të Mbrojtjes së Thaçit. Trupi
14 Gjykses urdhëron Mbrojtja e Thaçit që të dorëzojë një listë të
15 rishikuar të provave materiale sa më shpejt të jetë e mundur
16 por jo më vonë sesa të premtën, 14 nëntor 2025.

17 Këtu përfundon urdhri me gojë i Trupit Gjykses.

18 Përpara sesa të sjellim dëshmitarin në sallë, Trupi
19 Gjykses rikujton se parashtimi F03532, në këtë parashtim
20 Trupi Gjykses autorizoi masa të caktuara sipas rregullës 107
21 për këtë dëshmitar, duke përfshirë që, një, dëshmia e këtij
22 dëshmitari do kufizohet në tema të caktuara që janë renditur
23 dhe autorizuar në paragrafët 35 dhe 38 deri në 39 të të
24 njëjtë vendim, dy, fushëveprimi i marrjes në pyetje nga pala
25 jothirrëse do të kufizohet në pyetjet e bëra nga pala thirrëse

1 dhe çështje të besueshmërisë, tre, dëshmitari mund të refuzojë
2 t'i përgjigjet pyetjeve për shkaqe të konfidencialitetit dhe,
3 katër, përfaqësuesi i ofruesit të shërbimit sipas rregullës
4 107 do të jetë i pranishëm në sallën e gjyqit gjatë dëshmisë
5 së dëshmitarit.

6 Trupi Gjykues nuk do të lejojë pyetje të cilat nuk
7 demonstrohen qartazi se lidhen me autorizimin e dhënë për
8 afruesin e shërbimit sipas rregullës 107 dhe nuk janë
9 relevante për çështjen. Kur të pyetet lidhur me këtë pikë,
10 pala pyetëse duhet të jetë gati që të thotë se cilat janë
11 pistat përkatëse të pyetjeve të cilat kanë të bëjnë me
12 fushëveprimin e autorizimit sipas rregullës 107.

13 Znj. Sekretare e seancës, ju lutem silleni dëshmitarin në
14 sallë.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, një çështje
16 procedurale, në qoftë se mundemi?

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] A është e mundur që të ndryshojmë
19 edhe listën e dokumenteve të cilat do të përdoren për këtë
20 dëshmitar tani që morët vendimin që videoja do të pranohet në
21 listën tonë të provave materiale?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund ta
23 bëni këtë gjë.

24 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita,

1 Dëshmitar.

2 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëdita.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

4 Sekretare e seancës tani do t'ju jap tekstin e deklaratës
5 solemne të cilën duhet ta lexoni në pajtim me rregullën 141(2)
6 i rregullores. Ju lutem hidhini një sy dhe lexojeni me zë.

7 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e
8 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj
9 solemnisht se do ta them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe
10 vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të
11 cilën kam dijeni.

12 DËSHMITARI: CRITOPHER HILL

13 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
15 Dëshmitar. Tani mund të uleni.

16 Sa i takon prezantimeve, palët dhe pjesëmarrësit mbase e
17 panë që kemi një përfaqësuese të qeverisë së Shteteve të
18 Bashkuara që ka ardhur për të marrë pjesë në këtë seancë dhe
19 që ka lidhje me dëshminë e dëshmitarit.

20 Ju lutem prezantohuni për procesverbal.

21 ZNJ. GEARHART-SERNA: [Përkthim] Po, faleminderit, të
22 nderuar Gjykatës. Unë jam Terra Gearhart-Serna, jam
23 zëvendëskëshilltare ligjore e ambasadës së Shteteve të
24 Bashkuara në Hagë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 Besoj që e dini që e kemi autorizuar që mund të përdorni
2 kompjuterin tuaj. Por kjo është vetëm thjesht për t'u përdorur
3 prej jush, dhe nuk duhet të mbartë asnjë material ose asnjë
4 dokument për të cilin do të diskutojmë këtu. Besoj që e keni
5 të qartë këtë, apo jo?

6 Dëshmitar, kjo dëshmi e juaj planifikohet që të zgjasë
7 2.5 ditë. Sikurse mund ta dini, e para do t'ju bëj pyetje
8 Mbrojtja e Thaçit, më pas do t'ju bëjnë pyetje Ekipet e tjera
9 të Mbrojtjes. Pasi të përfundojnë të gjitha Ekipet e Mbrojtjes
10 me pyetjet e tyre, ZPS-ja do t'ju bëj pyetje. Pyetje mund t'ju
11 bëjnë dhe anëtarët e Trupit Gjykses.

12 Mbrojtja e Thaçit ka vlerësuar se i duhen tre deri në
13 katër orë për t'ju marrë në pyetje. Ekipet e tjera të
14 Mbrojtjes do të përdorin, pak a shumë, tre orë. ZPS-ja
15 vlerëson se i duhen katër deri në pesë orë. Si lidhur me çdo
16 vlerësim tjetër ne shpresojmë që avokatët do të jenë efikas në
17 përdorimin e kohës. Trupi Gjykses mund të lejojë pyetje
18 plotësuese në qoftë se do të përmbushen kriteret përkatëse.

19 Dëshmitar, ju lutem jepini përgjigje pyetjeve qartë dhe
20 me fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht
21 mund t'i kërkonit avokatit ta përsërisë pyetjen ose thojini që
22 nuk e kuptoni pyetjen dhe avokati do bëjë sqarimet përkatëse.
23 Gjithashtu, na thoni se cila është baza e njohurive dhe
24 rrethanave për të cilat do të pyeteni.

25 Ju lutem, flisni pranë mikrofonit dhe bëni një pauzë prej

1 pesë sekondash përpara se të jepni përgjigje për një pyetje
2 dhe flisni me ritëm të ngadaltë për t'ju kapur përkthyesit.
3 Edhe pse ne flasim në të njëjtën gjuhë, flasim në anglisht, ju
4 do të përktheheni në dy gjuhë të tjera, kështu që përkthyesit
5 duhet t'ju ndjekin, duhet të na ndjekin ne të gjithëve, kështu
6 që është e rëndësishme që të flasim ngadalë.

7 Gjatë ditëve që do të jepni dëshmi përpara Trupit
8 Gjykues, nuk lejoheni që të diskutoni me askënd për
9 përmbajtjen e dëshmisë tuaj jashtë sallë së gjyqit. Në qoftë
10 se një person jashtë sallës së gjyqit ju bën pyetje lidhur me
11 pyetjet tona këtu, ju lutem na e bëni menjëherë me dije këtë
12 gjë.

13 Nëse ju kërkoj që të mos flisni më dhe në qoftë se më
14 shikoni që ngre dorën, ju lutem ndaloni së foluri. Këto
15 udhëzime duan të thonë që unë duhet t'ju jap disa udhëzime.

16 Nëse e ndjeni të nevojshme për të bërë ndonjë pushim
17 gjatë marrjes në pyetje ose që të përsërisim diçka, ju lutem
18 na e thoni këtë gjë dhe ne do bëjmë organizimet përkatëse.

19 Së fundi, vërej që ju sot jeni i shoqëruar në sallën e
20 gjyqit nga një përfaqësuese e Qeverisë së Shteteve të
21 Bashkuara. Në këtë aspekt, Trupi Gjykues e ka marrë një vendim
22 paraprak lidhur me dëshminë tuaj e cila do të jetë e kufizuar
23 në fushëveprim dhe përfaqësuesi që është në Gjykatë sot mund
24 t'ju ndihmojë lidhur me këtë. Në qoftë se keni ndonjë dyshim
25 sa i takon fushëveprimin të dëshmisë tuaj, ju lutem na bëni

1 pyetje ne, anëtarëve të Trupit Gjykses ose përfaqësuesja mund
2 të bëjë gjithashtu pyetje.

3 Tani z. Misetic do të fillojë me pyetjet për ju.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

5 Pyetje nga z. Misetic:

6 Z. MISETIC: [Përkthim]

7 PY. Mirëdita, Ambasador Hill. Në fillim fare, a mund të na
8 thoni emrin dhe mbiemrin e plotë?

9 PË. Unë quhem Christopher Robert Hill.

10 PY. Cila është ditëlindja juaj?

11 PË. Më 10 gusht 1952.

12 PY. Çfarë shtetësie keni?

13 PË. Jam shtetas i Shteteve të Bashkuara.

14 PY. A është e saktë kjo që ju jeni diplomat në pension, pra,
15 diplomat amerikan i dalë në pension?

16 PË. Po.

17 PY. A e mbani titullin e ambasadorit dhe gjatë kohës së
18 pensionimit?

19 PË. Po, kjo është e saktë.

20 PY. A mund të na thoni pak se çfarë formimi keni? Dhe çfarë
21 diplomash keni marrë në karrierën tuaj?

22 PË. Po, patjetër. Unë kam diplomë në ekonomi, kam gjithashtu
23 dhe studime pasuniversitare. Kam diploma master nga Kolegji i
24 Luftës për Çështje Detare dhe gjithashtu kam punuar për
25 Departamentin e Shtetit për shumë vite. Pra, kam shumë

1 karrierë dhe shumë vite përvojë me Departamentin e Shtetit.

2 PY. Filluam që të flasim shumë shpejt, po kështu do ju
3 kërkoja që të flisnim pak më ngadalë.

4 PË. Në rregull.

5 PY. Ju thatë që keni një diplomë master në Kolegjin e Luftës
6 Detare. A mund të na e thoni se në çfarë studimesh e keni,
7 cila ka qenë tema e studimeve tuaja në këtë kolegji?

8 PË. Kam studiuar për sigurinë kombëtare.

9 PY. Në rregull. A mund të na thoni gjithashtu në qoftë se kjo
10 diplomë master ju ka dhënë juve njohuri lidhur me strukturat
11 ushtarake dhe organizata të tilla?

12 PË. Po.

13 PY. Kur e keni filluar karrierën diplomatike tuajën,
14 Dëshmitar?

15 PË. E kam filluar karrierën diplomatike në shërbimin e punëve
16 të jashtme në tetor në vitin 1977.

17 PY. A mund të na thoni se ku keni shërbyer në karrierën tuaj
18 diplomatike përpara 1998?

19 PË. Përpara vitit 1998, unë kam filluar që të bëhem aktiv në
20 shërbimin e huaj të Shteteve të Bashkuara në vitin 1977. Puna
21 ime e parë ka qenë në Beograd, në Jugosllavi, në verën e vitit
22 1978. Kam qenë atje dhe kam shërbyer si staf diplomatik deri
23 në verën e vitit 1980. Më pas jam kthyer në Shtetet e
24 Bashkuara në Departamentin e Shtetit në 1980 dhe kam shërbyer
25 si nëpunës i Departamentit të Shtetit. Më pas kam qenë anëtar

1 i stafit për planifikimin e politikave deri sa kam shkuar në
2 Varshavë në Poloni në vitin 1983. Jam larguar në Varshavë në
3 vitin 1985 dhe më pas kam shkuar në Seoul në Kore në vitin
4 1985 deri në vitin 1988. Në atë kohë, jam kthyer në Shtetet e
5 Bashkuara përsëri, pra, pasi mbarova shërbimin në Kore. Kam
6 punuar për një kongresmen në kuadrin e Departamentit të
7 Shtetit në periudhën nga 1988 deri në 1989. Në 1989 unë jam
8 bërë personi përgjegjës për Poloninë.

9 Ndërkohë në vitin 1991, në detyrën time të radhës shkova
10 në Shqipëri, në Tiranë, ku kam hapur ambasadën amerikane e
11 cila ishte mbyllur në Shqipëri që prej vitit 1946. Jam larguar
12 nga Shqipëria, pra, nga Tirana, kryeqyteti i Shqipërisë, në
13 vitin 1994 dhe në atë kohë u bëra drejtori për Zyrën e
14 Ballkanit në Departamentin e Shtetit, detyrë e cila kulminoi
15 në pjesëmarrjen time në bisedat për paqe të Dayton në tetor
16 deri në nëntor të 1995.

17 Më pas kam shkuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut në
18 verën 1996. Në vitin 1998, ndërkohë që kam qenë ende në
19 Republikën e Maqedonisë së Veriut, u bëra i dërguari i posaçëm
20 për çështjet serbe në Kosovë dhe i përfundova këto detyra në
21 verën e vitit 1999.

22 PY. Faleminderit. Do t'ju bëj një pyetje lidhur me këtë që
23 sapo na thatë. Në detyrën që keni pasur në Tiranë dhe në
24 Maqedoninë e Veriut, a keni pasur mundësi që të udhëtonit në
25 Kosovë ose të njiheshit me çështje shqetësuese në Kosovë në

1 atë kohë?

2 PË. Kosova ishte një temë shumë e madhe brenda Ballkanit,
3 temë e rëndësishme, por, në atë kohë nuk ishte e vetmja
4 çështje që diskutohej sepse sikurse dihet kishte shumë luftëra
5 që ndërhyjnë në këtë çështje duke përfshirë këtu luftën në
6 Bosnjë dhe ndërmjet Serbisë dhe Kroacisë. Megjithatë, ndërkohë
7 që kam qenë në Shqipëri, pra, gjatë dy viteve të punës time në
8 Shqipëri, unë kam dëgjuar shumë lidhur me situatën në Kosovë.
9 Nuk e kam vizituar personalisht Kosovën deri në maj të vitit
10 1998 kur mu kërkua që ta merrja përsipër si një përgjegjësi
11 shtesë përveç përgjegjësisë të tjera të cilat unë i kisha si
12 ambasador i Shtetet e Bashkuara në Shkup.

13 PY. Faleminderit. A u kthyet në Shtetet e Bashkuara në 1999
14 dhe në qoftë se po, çfarë detyre ke mbajtur në vitin 1999 dhe
15 në vitin 2000?

16 PË. Jam kthyer në Shtetet e Bashkuara në 1999, më saktë në
17 verën e vitit 1999. Në shtator të 1999 u bëra drejtor i lartë
18 i Këshillit Kombëtar të Sigurimit, drejtor i lartë për çështje
19 të Evropës Juglindore, përkatësisht për Ballkanin. Këto detyra
20 i kam kryer deri në verën e vitit 2000, pikë në të cilën jam
21 dërguar në Varshavë në Poloni si ambasador i Shtetet e
22 Bashkuara atje.

23 PY. Si pjesë e detyrave tua si në shtabin e Kombeve të
24 Bashkuara, e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, a
25 ishte Kosova pjesë e portofolit tuaj?

1 PË. Po.

2 PY. Çfarë gjuhësh flisni ju?

3 PË. Ky është një funksion i cili ka ndryshuar, megjithatë më
4 duhet të them që kam folur gjuhën polake në nivel bisedash,
5 kam qenë në gjendje që të diskutoj në polonisht, serbisht, po
6 ashtu kam folur dhe mund të flas dhe pak shqip.

7 PY. Faleminderit. Ju përmendët që keni qenë i përfshirë në
8 bisedat e paqes në Dayton. A keni punuar me Ambasadorin
9 Holbrooke në atë kohë?

10 PË. Po, çdo ditë.

11 PY. A ka qenë Kosova një prej bisedave, një temë e diskutuar
12 në bisedat e Dayton?

13 PË. Bisedat e Dayton kanë qenë të përqendruara në përfundimin
14 e luftës në Bosnjë. Megjithatë, çështja e Kosovës ka dalë në
15 disa rrethana kur kishte qytetarë, shtetas amerikan me
16 prejardhje kosovare të cilët dëshironin që ne të trajtonim
17 edhe çështjen e Kosovës, megjithatë vëmendja kryesore ka qenë
18 në atë kohë në krizën në Bosnjës se për këtë ka të bëjë
19 Marrëveshja e Dayton.

20 Gjithsesi, ne diskutonim lidhur me Kosovën. Për shembull,
21 më kujtohet që kam pasur biseda të drejtpërdrejta me
22 presidentin Milosevic në kontekstin e marrëveshjes së paqes së
23 Dayton sepse e dinim që Kosova do ishte çështja tjetër e
24 radhës.

25 PY. Ju sapo thatë që jeni takuar me presidentin Milosevic. Në

1 atë kohë, domethënë, në bisedat e Dayton dhe më parë, a keni
2 pasur mundësi që të takoheshit me persona ose zyrtarë të tjerë
3 me rëndësi ose me peshë në Ballkan?

4 PË. E keni fjalën këtu për Kosovën?

5 PY. E kam fjalën për Kosovën, Bosnjën, Kroacinë, Serbinë?

6 PË. Gjatë Marrëveshjes së Pages së Dayton, sigurisht, kemi
7 pasur biseda me presidentin e Kroacisë, me presidentin e
8 Serbisë, me zyrtarë të lart, përfshirë këtu edhe presidentin e
9 Bosnjës, kështu që këta janë disa prej personave me të cilët
10 unë kam folur përditë. Ndërkohë aty nuk kishte përfaqësues nga
11 Kosova po as nga Shqipëria.

12 Përpara sesa të fillonim me bisedat e pages në Dayton,
13 unë kam shkuar dhe kam vizituar Maqedoninë në kuadrin e
14 trajtimit të disa prej çështjeve që kishte ose disa prej
15 problemeve që kishte Maqedonia aso kohe.

16 Nuk kam pasur rast që të përfshihem me liderët ose me
17 udhëheqësit e Kosovës. Megjithatë, do them që, duke ju kthyer
18 përsëri 1989, mund të them tani që kam pasur mundësi që të
19 takohem me z. Rugova në rezidencën e ambasadorit amerikan.
20 Pra, kjo ka qenë biseda ose takimi im i parë që kam pasur me
21 Ibrahim Rugovën, jam takuar në shtëpinë e ambasadorit
22 amerikan. Jam takuar më pas me të në vitin 1998, në maj të
23 1998 për të qenë më konkret.

24 PY. Të përfundojmë me formimin tuaj, ju përmendët që u
25 caktuat me detyrë në Poloni në vitin 2000. Pas detyrës tuaj në

1 Poloni në vitin 2000, a mund të na thoni se çfarë detyrash
2 tjera keni kryer në karrierën tuaj?

3 PË. Pas Polonisë, pra, jam larguar nga Polonia në vitin 2004
4 dhe në atë kohë më pas kam shkuar në Kore si ambasador i
5 Shteteve të Bashkuara në Kore. Aty kisha qenë dhe më përpara,
6 sikurse e përmenda në fillim fare të prezantimit tim,
7 domethënë, kisha shërbyer në Kore në vitin 1985 deri në 1988
8 dhe mbas Varshavës, mbas Polonisë, shkova në Kore në vitin
9 2004.

10 Më pas, Sekretarja e Shtetit Condoleezza Rice më kërkoi
11 që të përfundoja detyrën time në Kore dhe të bëhesha
12 zëvendëssekretari i Shtetit për Azinë, që ishte kjo një detyrë
13 e cila filloi në pranverën e vitit 2005. Ajo më kërkoi që të
14 merrja përsipër detyrën e drejtimit të delegacionit amerikan
15 në bisedat me koreanët e veriut, detyrë të cilën unë e kreja
16 për katër vite, nga viti 2005 deri në vitin 2009.

17 Në vitin 2009, administrata e presidentit Obama, që erdhi
18 në detyrë më kërkoi që të shkoja në Bagdad dhe të bëhesha
19 ambasador i Shteteve të Bashkuara në Irak, gjë të cilën unë e
20 pranova dhe si rezultat shkova dhe shërbeva si ambasador atje
21 në vitin 2009. Unë u pensionova nga Shërbimi i Huaj i Shteteve
22 të Bashkuara në vitin 2010 dhe u ktheva në akademi, në botën
23 akademike dhe më pas u ktheva përsëri në shërbimin e huaj të
24 Shteteve të Bashkuara në vitin 2022 si ambasador i Shteteve të
25 Bashkuara në Serbi. E kam mbajtur këtë post deri në këtë vit,

1 domethënë, deri në janar të këtij viti, pra, deri në janar të
2 vitit 2025.

3 PY. Faleminderit. Në përvojat tua si diplomat karriere, a
4 jeni takuar në mënyrë të rregullt me drejtuesit e shteteve?

5 PË. Po.

6 PY. A jeni takuar dhe me ministra të qeverisë?

7 PË. Po, gjatë gjithë kohës

8 PY. A jeni takuar me zyrtarë ushtarakë?

9 PË. Po.

10 PY. A jeni takuar me zyrtarë të shërbimit inteligjent të
11 huaj?

12 PË. Po.

13 PY. Po aktorë jo shtetërorë a jeni takuar?

14 PË. Në qoftë se e keni fjalën në qoftë se jam takuar me
15 njerëz të biznesit ose njerëz të tjerë të kësaj natyre të
16 qeverive të huaja? Përgjigja është po.

17 PY. Si diplomat, a ishte puna juaj kryesore që të vlerësonit
18 dhe të dinit se çfarë rolesh dhe çfarë autoritetesh kishin
19 persona të caktuar me të cilët juve ndërvepronit ose ishit në
20 biseda dhe në kontakte të vazhdueshme?

21 PË. Gjatë gjithë kohës. Kjo ishte detyra ime kryesore që të
22 kuptoja situata, që të dëgjoja me vëmendja, të kuptoja
23 marrëdhëniet e fuqive dhe gjithashtu që të kuptoja atë çfarë
24 ndodhte brenda qeverive përkatëse dhe jashtë qeverive dhe të
25 mundoja që të ndihmoja që të formuloheshin politikat e

1 Shteteve të Bashkuara mbështetur në këto njohuri që unë
2 grumbulloja.

3 PY. Ju na thatë që keni shërbyer dhe në botën akademike. Mund
4 të na thoni se me çfarë lidhet kjo pjesë e përvojës tuaj?

5 PË. Në botën akademike, unë u bëra dekan i shkollës
6 ndërkombëtare të Universitetit të Denverit. Kam punuar atje
7 për tetë vite dhe më pas kësaj periudhe u bëra këshilltar për
8 kancelarin e Universitetit të Denverit. Më pas, sikurse e kam
9 thënë dhe më herët, unë shkova dhe kam dhënë mësim në
10 Universitetin e Kolumbias për një semestër dhe pas kësaj
11 periudhe u ktheva përsëri në Shërbimin e Huaq të Shteteve të
12 Bashkuara dhe shkova si ambasador në Serbi.

13 PY. A keni poste akademike sot, a ushtroni ndonjë detyrë
14 akademike sot?

15 PË. Po, jam profesor në Shkollën Fletcher, që është shkollë e
16 të drejtës ndërkombëtare.

17 PY. Faleminderit.

18 PY. Nuk e di në qoftë se mund të shtoj dhe diçka tjetër, dua
19 të them që Shkolla Fletcher është një shkollë e dedikuar për
20 diplomacinë ndërkombëtare dhe të drejtën ndërkombëtare.

21 PY. Faleminderit. Lidhur me angazhimin tuaj për çështjen e
22 Kosovës për herë të parë. A mund të na thoni se kur jeni
23 përfshirë për herë të parë, kur ju ka përfshirë qeveria e
24 Shteteve të Bashkuara për herë të parë për t'u përpjekur për
25 të zgjidhur tensionet në Kosovë?

1 PË. Së pari jam përfshirë nga qeveria e Shteteve të Bashkuara
2 në maj të vitit 1998.

3 PY. Kush ju kërkoi që të përfshiheshit në çështjen e Kosovës?

4 PË. Mora një telefonatë nga Sekretari i Shtetit i asaj kohe,
5 që ishte Sekretarja e Shtetit asaj kohe, që ishte Madeleine
6 Albright që më kërkoi që përveç detyrave të mia si ambasador i
7 Shteteve të Bashkuara në Maqedoni të merrja përsipër
8 gjithashtu edhe postin e të dërguarit të posaçëm në Kosovë.

9 PY. Si i dërguari i posaçëm në Kosovë, kujt i raportoni ju?

10 PË. Unë në këtë rol timin i raportoja Sekretares së Shtetit
11 Madeleine Albright. Megjithatë, më duhet të shtoj, se në këtë
12 kohë Holbrooke ishte shumë i interesuar për çështjen e Kosovës
13 edhe më këshillonte vazhdimisht për çështje që kishin të bënin
14 me Kosovën dhe isha i informuar, pra, lidhur me zhvillimet
15 atje.

16 PY. A e kishit kuptuar ju që Sekretarja Albright mbështetej
17 në vlerësimet tuaja si i dërguari i posaçëm?

18 PË. Po, ajo mbështetej shumë prej vlerësimeve të mia,
19 megjithatë bazohej edhe tek informacionet e dhëna nga persona
20 të tjerë në terren.

21 PY. Cili ishte mandati juaj si i dërguari i posaçëm për
22 Kosovën?

23 PË. Në fillim fare, unë e kuptova rolin tim që ne duhet të
24 ofronim një lloj mbështetjeje ose zgjidhjeje politike dhe
25 duhet që të ndihmonim që të sprapseshin forcat atje nga dhuna

1 në rritje e mundur. Dhe, që në fillim fare, unë jam përpjekur
2 që me kolegë dhe me Departamentin e Shtetit të mund të
3 ndërtonim një plan autonomie në mënyrë të tillë që të
4 rikthehej autonomia e Kosovës dhe në mënyrë të tillë që Kosova
5 të kishte vetëqeverisjen e vetë. Domethënë, kjo ishte ideja
6 kryesore, pista kryesore që ne ndiqnim me Kosovën dhe me
7 Serbinë.

8 PY. Pse ishte e rëndësishme që të përpiqeshit që të arrinit
9 një zgjidhje politike?

10 PË. Mendoj se është gjithmonë e preferueshme që të gjendet
11 një zgjidhje politike në vend të qasjeve të tjera, por në këtë
12 rast është veçanërisht e rëndësishme sepse partnerët tanë
13 evropianë dhe aleatët, një pjesë e tyre, ishin të shqetësuar
14 për shpërthim të mundshëm të dhunës përsëri në kontinent dhe
15 donin, pra, shumë këmbëngulnin që të arrihej një zgjidhje
16 politike.

17 Për këtë arsye kemi punuar ngushtë me evropianët që kemi
18 patur deri në Marrëveshjen e Dejtonit, pra, Marrëveshjen e
19 Paqë.

20 PY. Gjatë punë tuaj me aleatët evropianë ka qenë diçka që
21 quhej si Grupi i Kontaktit, apo jo, në qoftë se mund të na
22 sqaroni?

23 PË. Po përpiqem të pres pesë sekonda, pra, po nuk po ja
24 arrij.

25 Atëherë Grupi i Kontaktit ishte një mekanizëm koordinues

1 ku përfshiheshin interesat e Rusisë dhe të Shteteve të
2 Bashkuara dhe të evropianëve. Pra, nuk përfshinte të gjitha
3 shtetet evropiane që kishin interes të veçantë. Përfshinte
4 Gjermaninë, Francën, Mbretërinë e Bashkuar dhe më vonë filloi
5 të përfshinte dhe Italinë sepse Italia kishte interes të madh
6 në Ballkan, se gjeografikisht janë afër Italisë këto vende të
7 Ballkanit. Pra, përfshinte edhe përfaqësues nga Rusia dhe,
8 natyrisht, Shtetet e Bashkuara.

9 Grupi i Kontaktit ishte në nivele të ndryshme. Ishte
10 niveli im si negociator, por kishte dhe ministra të cilët
11 mbledheshin si pjesë e Grupit të Kontaktit dhe diskutonin
12 lëvizjet e mëtejshme për Kosovën.

13 PY. Për sa i përket përgatitjes tuaj për punën tuaj si i
14 dërguari i posaçëm, në punën tuaj të përditshme a
15 përfshiheshin dhe leximi i raporteve të shtypit mbi rajonin,
16 pra, lidhur me rajonin?

17 PË. Po. Puna ime e përditshme përfshinte leximin e raporteve
18 të shtypit si dhe koordinimin me palë të tjera të interesuara
19 ku përfshiheshin natyrisht disa shtete evropiane përtej Grupit
20 të Kontaktit.

21 PY. A keni lexuar kabllograme diplomatike të Shteteve të
22 Bashkuara?

23 PË. Po. Kam lexuar prej tyre dhe disa i kam shkruar vetë.

24 PY. A ju kujtohet nga cilat pozita janë shkruar këto
25 kabllogram?

1 PË. Janë shkruar --

2 PY. Nga cilat vende, pra, cilat ambasada apo misione
3 diplomatike?

4 PË. Janë shkruar nga disa vende evropiane sepse ambasadorët
5 atje kishin diskutuar çështjen, kishin diskutuar dhe çështja e
6 Kosovës ishte paraqitur si e pranishme dhe ambasada në vendin
7 e caktuar ku bëhet fjalë në Evropë mund të dërgonte një
8 kabllogram lidhur me këtë çështje.

9 Ka patur kabllogram në numër të madh, për të thënë këtë
10 në mënyrë diplomatike, që disa ishin më të dobishëm më me
11 interes sesa të tjerë.

12 PY. A i keni lexuar raportet e shërbimit të zbulimit në
13 mënyrë të rregullt?

14 PË. Si pjesë e detyrave të mia, po.

15 PY. A ishin raporte të papërpunuara apo ishin në të
16 rishikuara?

17 PË. Do thoja të dyja.

18 PY. A keni marrë informacion nga stafi, *briefing* nga stafi i
19 ambasadës?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe a përfshinte kjo dhe ambasadën në Beograd?

22 PË. Po, përfshinte ambasadën në Beograd, por në kohën kur
23 isha unë atje personi në terren isha vetë unë dhe pastaj
24 natyrisht kemi krijuar një organizatë monitorimi.

25 PY. A keni marrë informacion nga pjesë të tjera të

1 Departamentit të Shtetit dhe Këshilli i Sigurisë Kombëtare?

2 PË. Po. Kosova ishte çështje parësore. Dhe nëse, për
3 shembull, sekretari ka pritur në vizitë një ministër të punëve
4 të jashtme nga një vend evropian shanset ishin të mëdha që një
5 prej pikave që do të diskutoheshin ishte Kosova. Pra, dikush
6 nga stafi i sekretarit më komunikonte faktin që ajo kishte
7 diskutuar dhe çështjen e Kosovës.

8 Sekretari, natyrisht, është gjithmonë i përgatitur për të
9 disa tema paraprakisht. Disa prej këtyre temave përfshinin
10 marrëdhënie në përgjithësi mes Shteteve të Bashkuara dhe
11 vendeve evropiane, për shembull, por në atë ditë Kosova dukej
12 që ishte një prej çështjeve, ka qenë një prej çështjeve për
13 t'u diskutuar. Dhe të paktën sa i takon Kosovës njerëzit e
14 dinin se Sekretari kishte thënë, atë që kishte thënë apo që
15 kishte dëgjuar nga diplomatët e huaj.

16 PY. Si pjesë e mandatit tuaj për të gjetur një zgjidhje
17 politike, a jeni përpjekur të identifikoni pikat e kontaktit
18 dhe autoritetin në të dyja anët, pra, si anën serbe dhe anën -
19 - palën serbe dhe palën e Kosovës?

20 PË. Po, e kam bërë. Dhe ishte shumë e rëndësishme që të
21 bisedonim me palët e ndryshme të cilat do ishin ose pjesë e
22 zgjidhjes ose pjesë e problemit pastaj. Dhe po. Kam kaluar
23 shumë kohë në përpjekje për t'u marrë, për të komunikuar me
24 njerëzit goftë nga pala serbe dhe nga pala e Kosovës.

25 PY. Nga pala serbe me kë keni punuar?

1 PË. Nga pala serbe kam punuar kryesisht me presidentin
2 Milosevic dhe ekipin e tij. Ku përfshiheshin ish-ministri i
3 punëve të jashtme dhe në një pikë të caktuar kryeministër, z.
4 Milutinovic. Por nga pala serbe ishte shumë e kufizuar dhe
5 ishte kryesisht Milosevic.

6 PY. Po në palën shqiptare të Kosovës, a gjetët ndonjë që mund
7 të fliste me autoritet në emër të shqiptarëve të Kosovës?

8 PË. Kjo në atë kohë ka qenë një sfidë e madhe në disa momente
9 ishte ndërmarrje e vështirë që të gjendeshin njerëzit që mund
10 të flisnin me autoritet. Secili, çdokush kishte një mendim
11 lidhur me këtë. Nuk ishte problemi që të gjendej dikush që
12 kishte një mendim. Problemi ishte që të gjendej dikush që
13 kishte autoritet.

14 Një prej personave ishte natyrisht ishte kreu i Lidhjes
15 Demokratike të Kosovës, LDK-ja, që ishte Ibrahim Rugova. Ai
16 kishte patur këtë pozitë udhëheqjeje në Kosovë edhe pse ishte
17 një pozitë udhëheqjeje joformale, po kishte mbajtur këtë
18 pozitë për një dekadë. Siç ua përmenda, u takova me të për
19 herë të parë në vitin 1999 në rezidencën e ambasadorit
20 Zimmerman dhe ai ishte një udhëheqës në Kosovë i mirëvendosur
21 dhe i mirëpranuar. Por për kundër Serbisë, presidenti Rugova
22 nuk ishte personi i vetëm me të cilin mund të bisedohej në
23 Kosovë sepse nuk përfaqësonte të gjitha pikëpamjet.

24 PY. A mund të përshkruani dallimin në vitin 1998 midis
25 angazhimit tuaj me palën serbe dhe me atë kosovare sa i takon

1 organizimit, strukturës, vijës së autoritetit dhe

2 vendimmarrjes?

3 PË. Që të sigurohem që e kam kuptuar pyetjen siç duhet, ju

4 doni të dini për vijën e autoritetit në procesin e

5 vendimmarrjes në Serbi dhe të njëjtën gjë në Kosovë apo në

6 mesin e shqiptarëve të Kosovës?

7 PY. Po, cilat ishin dallimet, pra, në goftë se ka patur?

8 PË. Tani në Serbi dhe nuk duhet që të tregohem i ashpër me

9 këtë, por ishte vetëm një person me të cilin ne komunikim,

10 mund të merrnim shumë informacione dhe shumë qartësi nga

11 bisedat, nga një bisedë me presidentin Milosevic. Kjo situatë

12 nuk reflektohej, kjo nuk pasqyrohej në Kosovë. Në Kosovë

13 kishte diskutime, këto ishin diskutime që unë kam bërë me

14 presidentin Rugova por nuk ishin të mjaftueshme që të kishte

15 për të kuptuar në mënyrë të gjerë pozitën e Kosovës, as

16 presidenti, unë po e thërras atë president, e quaja president

17 sepse Rugova kishte titullin si kryesues i LDK-së, kryetar i

18 LDK-së. Por edhe sikur të flisja me të nuk mund të prisja që

19 diçka të zbatohet, pra, duhet të shkonim më tej se kaq.

20 PY. Ju përmendët Ambasadorin Holbrooke që kishte një interes

21 në këtë çështje. A mund të na thoni rolin, të na tregoni ne

22 rolin e Ambasadorit Holbrooke në këtë periudhë?

23 PË. Mendoj që është e drejtë të themi se Ambasadori Holbrooke

24 ka dhënë një kontribut historik për paqen dhe sigurinë në

25 Ballkan në Dejton që e kishte dhënë këtë kontribut dhe ndiehej

1 i frustruar se Dejtoni -- se vazhdonin të ishin problemet të
2 pranishme në Ballkan dhe pas Dejtonit dhe kjo sepse ishin
3 përqendruar në Bosnjë në Dejton, pra, gjatë bisedimeve në
4 Dejton, që ishte qëllimi i kësaj konference, ai mendonte që
5 duhej të angazhohej në një mënyrë apo një tjetër për të
6 ndihmuar Kosovën që të gjente një zgjidhje.

7 Dhe më dha shumë këshilla lidhur me atë që duhet të bëja
8 në Kosovë, disa prej këtyre i kërkoja, disa prej tyre nuk i
9 kërkoja. Dhe ai më dha gjithashtu këshilla, këshilloi dhe
10 këshilltaren Albright dhe mendoj që e njëjta vlen edhe për
11 atë, disa prej këshillave që vinin nga ai i kishte kërkuar
12 ajo, disa jo. Ambasadori Holbrooke ishte jashtëzakonisht
13 aktiv, personazh shumë i angazhuar, kishte mendime të shumta
14 dhe shumë prej tyre ishin mendime të vlefshme, pra, në
15 përgjithësi njerëzit i kushtojnë vëmendje atyre që kishte për
16 të thënë ai.

17 PY. Erdhi ndonjë moment kur Shtetet e Bashkuara inkurajuan z.
18 Rugova që të takohej me z. Milosheviq dhe, nëse po, pse?

19 PË. Po. Kjo ishte hera e parë kur ambasadori Holbrooke shkoi
20 në Prishtinë. Shkova me të edhe unë. Dhe ne u ulëm me
21 Presidentin Rugova edhe pse nuk e kishim diskutuar këtë
22 paraprakisht, Ambasadori Holbrooke mendoj që do të ishte ide e
23 mirë nëse Rugova do të takohej me z. Milosheviq në Beograd
24 sepse shpresonte që ky takim mund dhe do të zgjidhte shumë
25 probleme. Unë dua të them, isha shumë më skeptik.

1 PY. Ju kujtohet kur ndodhi takimi mes z. Rugova dhe z.

2 Milosheviq dhe ku?

3 PË. Kjo ndodhi në Beograd, në presidencë në Beograd, në fund
4 të majit apo fillim të qershorit. Është pyetje empirike dhe
5 duhet të jem në gjendje, do doja të isha në gjendje t'ju jap
6 datën e saktë për këtë.

7 PY. Pra, në maj apo qershor 1998?

8 PË. 1998, po. Kjo ka qenë menjëherë pasi kam filluar unë në
9 punën time si i dërguari i posaçëm në Kosovë.

10 PY. Ju kujtohet në qoftë se takimi i z. Rugova me z.

11 Milosheviq pati ndonjë impakt apo ndikim në qëndrimin që
12 kishte Kosova lidhur me shoqërinë, atraksionin apo imazhin që
13 kishte z. Rugova në sytë e shoqërisë shqiptare të Kosovës?

14 PË. Mendoj që është e drejtë të themi që kjo ishte çështje
15 analize dhe mendimi për të cilin unë mund të flas. Mendoj që
16 kjo e dëmtoi atë. E dëmtoi z. Rugova sepse nuk mendoj që
17 kishte mendim të fuqishëm në Kosovë sa i takon takimit, faktit
18 që takimi me Milosheviqin mund të ndihmonte. Njerëzit nuk
19 mendonin një gjë të tillë. Dhe unë kisha rezerva lidhur me
20 faktin që kjo mund të ndihmonte atë, dhe vazhdoj të kem ato
21 rezerva nëse kjo e ndihmoj atë apo jo. Edhe ai ishte shumë i
22 shqetësuar për faktin, pra, pyetjen që a ishte ide e mirë kjo
23 apo jo, por ai nuk donte të gjendej në situatën dhe në takimin
24 e parë me ambasadorin Holbrooke nuk donte që të gjendej në
25 situatën ku refuzonte një sugjerim të tillë që vinte nga

1 Holbrooke.

2 PY. A pati kundërshtim ndaj z. Rugova në Prishtinë, ndaj vetë
3 z. Rugova, kundërshtime?

4 PË. Mendoj që është e drejtë të themi se z. Rugova ishte
5 udhëheqës jo formal i të gjithë Kosovës dhe mendoj që
6 kundërshtimi ndaj tij po rritej, po shtohej, sepse kishte një
7 lloj përshtypjeje, ndjenje që ai nuk po arrinte progres, nuk
8 po përparonte.

9 PY. A e dini kush mund të ketë qenë udhëheqësit e
10 kundërshtimit apo opozitës, pra, kundërshtimit ndaj tij brenda
11 në Prishtinë?

12 PË. Nuk jam në gjendje t'ua them këtë gjë, por mund t'ju them
13 që njerëzit me të cilët jemi takuar shpesh ishin shumë të
14 frustruar me z. Rugova dhe me strukturave të LDK-së. Disa prej
15 këtyre personave ishin me neve në Konferencën e Rambujesë në
16 vitin në vijim. Pra, z. Rugova, mendoj, kishte po kalonte një
17 moment të vështirë për të justifikuar apo për të legjitimuar
18 udhëheqjen e tij dhe ndjenja e arritjes së diçkaje në raport
19 me Serbinë. Dhe dua të theksoj kontekstin e kësaj ishte sepse
20 Bosnja po ecte, kishte një mënyrë, një rrugëdalje, pra, një
21 zgjidhje për të ecur përpara falë Marrëveshjes së Dayton,
22 ndërsa Kosova ishte akoma e bllokuar.

23 PY. A patët mundësinë të diskutonit me intelektualët siç janë
24 Veton Surroi dhe Rexhep Qosja?

25 PË. Po. Dhe është e drejtë të themi që kishte shumë

1 skepticism lidhur me aftësinë e tij për të arritur diçka apo
2 për të bërë përparime lidhur me këtë pikë. Çështja e
3 menjëhershme për Kosovën ishte që të përpiqeshim të krijohej
4 një republikë e ndarë. Serbët nuk pajtoheshin me këtë sepse
5 ata e konsideronin një republikë të ndarë si një agjendë
6 esecioniste, siç ishin republikat e tjera në pjesën
7 perëndimore të Jugosllavisë të cilat kishin deklaruar
8 pavarësinë e tyre.

9 PY. Përveç këtyre çështjeve për të cilat ju dhatë dëshmi sa i
10 takon kritikës dhe aftësisë së tij për të udhëhequr Kosovën, a
11 kishte ndonjë çështje tjetër që shkaktoi këtë kritikë ndaj
12 Rugovës dhe LDK-së?

13 PË. LDK-ja ishte entitet politik shumë i mirëorganizuar.
14 Ishte i financuar, kishte një sistem shkollor paralel dhe
15 ilegal, organizatë edukimi, shkollimi në mënyrë që fëmijët të
16 cilët nuk, pra, që fëmijët të mos shkojnë në shkollat serbe
17 por të shkojnë në një shkollë paralele, sistem paralel shqip.
18 Për këtë duheshin financime dhe ai ka mbledhur financime në
19 vende të Evropës, në Evropën Perëndimore ku vinin kryesisht
20 këto financime nga komuniteti etnik shqiptar. Dhe mendoj që
21 është e drejtë të themi që kishte shumë kritikë lidhur me
22 shpërdorimin dhe mënyrën sesi përdorreshin këto fonde.

23 PY. Të kalojmë tek kontakti i parë që keni patur me UÇK-në. A
24 e dini nëse dikush apo ndokush që vepronte të emër të Shteteve
25 të Bashkuara që bëri kontaktin e parë me UÇK-në, kur, pra,

1 ndodhi kjo që dikush, një përfaqësues i Shteteve të Bashkuara
2 pati kontaktin e parë me UÇK-në?

3 PË. Kjo është pyetje e thjeshtë për t'u përgjigjur, do të
4 duhej të ishte kështu, por nuk është në fakt pyetje e
5 thjeshtë. Problemi i madh, natyrisht, është se UÇK-ja ishte --
6 me UÇK-në ishte paaftësia dhe pamundësia për të gjetur një
7 udhëheqje aty, për të gjetur njerëz që mund të flisnin me
8 autoritet.

9 Robert Gelbard, i cili kishte mbajtur pozitën që kisha
10 mbajtur unë deri në momentin që atij i ishte kërkuar të
11 përqendrohej tërësisht në Bosnjë, pra, bëhet fjalë në maj të
12 1998, ai kishte patur disa takime me shqiptarë të Kosovës në
13 Zvicër dhe kishte dëgjuar se ata ishin përgjegjës të UÇK-së.
14 Nuk mendoj që kjo është e vërtetë dhe nuk ka patur asnjë provë
15 që të mund të sugjerohej që ata ishin në fakt të tillë, pra,
16 si udhëheqës të UÇK-së. Dhe nuk më kujtohet kush ishin ata.
17 Kërkoj ndjesë, por e di që janë bërë përpjekje nga ai. Ai ka
18 bërë përpjekje dhe të tjerë kanë bërë përpjekje për të gjetur
19 se kush ishte për të zbuluar, kuptuar se kush po e udhëhiqte
20 UÇK-në. Dhe kjo ishte e qartë në ato biseda se njerëzit me të
21 cilët kishte biseduar kishin simpati të madhe ndaj qëllimeve
22 të UÇK-së, pra, ajo që kërkohej ishte një lëvizje më e shpejtë
23 dhe e përsheptuar drejt pavarësisë por nuk ishte e qartë fare
24 se ata kishin ndonjë gjë për të thënë lidhur me të më shumë
25 sesa dikush tjetër.

1 PY. Ju përmendët Ambasadorin Gelbard. Në ndonjë moment të
2 caktuar Ambasadori Gelbard ju referua UÇK-së si organizatë
3 terroriste?

4 PË. Po. Dhe kjo ishte pjesë e disa ngjarjeve në vijimësi që
5 sollën çështjen e Kosovës në një nivel krize. Ambasadori
6 Gelbard, si shumë zyrtarë të shërbimeve të jashtme të tjerë,
7 mbështetej shumë në përvojat e të kaluarës. Përvojat e tij të
8 kaluara kishin qenë në Amerikën Latine ku ai ishte marrë,
9 kishte trajtuar problemet e tregtisë së narkotikëve dhe
10 çështje të tjera që përfshinin krimin e organizuar. Në një
11 moment të caktuar, ai bëri një deklaratë të tillë dhe tha se
12 ishte marrë, kishte trajtuar çështje të tilla me organizata të
13 ndryshme kriminale dhe përdori termin "terrorist" dhe që ai e
14 konsideronte UÇK-në si terroriste. Kjo ishte në shtyp, ishte
15 koment që ai bëri për shtypin dhe kjo ndodhi menjëherë, pak
16 kohë më pas një incidenti në të cilin forcat e sigurisë serbe
17 rrethuan shtëpinë e familjes Jashari dhe për pasojë të gjithë
18 u vranë aty. Ky ishte një shpërthim i madh i veprimeve
19 armiqësore.

20 Pati shumë kritika lidhur me deklaratën e z. Gelbard,
21 pra, se UÇK-ja ishin terroristë dhe se kjo kishte në një farë
22 mënyre përshpejtuar këtë ngjarje të veçantë, zhvillimin e
23 kësaj ngjarje, pra, të shkaktuar nga forcat e sigurisë serbe
24 dhe në një farë mënyre ndihej se z. Gelbard, pra, Gelbard
25 sikurse i kishte dhënë dritën jeshile që kjo të ndodhte. Besoj

1 që nuk ka, dua të shtoj, që nuk ka prova për një gjë të tillë.
2 Por kjo është sigurisht ajo që është diskutuar, pra, se nëse i
3 dërguari amerikan e quan UÇK-në terroriste kjo në një farë
4 mënyre i jep sinjal serbe që të bëjnë lëvizje kundër tyre.

5 Gelbard pastaj mori qëndrimin shumë të ashpër ndaj
6 serbëve pasi bënë këtë gjë dhe u përfshinë në këtë sulm kundër
7 këtyre njerëzve dhe kjo përfshiu dhe bisedë shumë të ashpër që
8 z. Gelbard pati me Milosheviqin me pasojën që Milosheviqi tha
9 se ai nuk donte dhe kjo pati për pasojë, pra, që Milosheviqi
10 nuk donte të takohet më me z. Gelbard.

11 Pra, e gjithë çështja në maj filloi me fjalimin apo
12 komentet e z. Gelbard lidhur me njohurinë që kishte ai të
13 mëparshme, nga përvojat e tij të mëparshme për kriminelët dhe
14 terroristët në Amerikën Latine dhe kjo çoi, kulminoi në këtë
15 sulm mbi familjen Jashari. Pastaj më vonë Gelbard e korrigjoi
16 këtë qëndrim dhe Milosheviqi refuzoi që të takohet më me z.
17 Gelbard. Dhe u desh që të ndodhte diçka e tillë e rëndë, kjo
18 ishte diçka e rëndë dhe që çoi në diçka dhe më të rëndë që
19 shkaktoi vdekje.

20 PY. Si pyetje në kontekst, Shtetet e Bashkuara kanë ndonjë
21 proces formal për të emërtuar organizatat e huaja terroriste?

22 PË. Shtetet e Bashkuara kanë një proces formal për emërtimin
23 e një organizate të huaj terroriste dhe me sa më kujtohet kjo
24 nuk është bërë asnjëherë në asnjë moment lidhur me UÇK-në.

25 PY. Faleminderit. Kur keni patur kontaktin e parë me UÇK-në?

1 PË. Çështja për mua është se në verë të 1998-s, ndërsa punoja
2 me stafin tim dhe të tjerë, çështja ishte që të gjenim një
3 zyrtar të UÇK-së apo një grup zyrtarësh me të cilët mund të
4 flisnim lidhur me UÇK-në. Dua të shtoj që kam punuar për një
5 farë kohe në këtë drejtim pa patur sukses dhe ne arritëm në
6 përfundimin që nuk ekzistonte një udhëheqje e tillë, pra, që
7 këtu bëhej fjalë më shumë për një grup njerëzish në nivel
8 vendor që ishte mendoj një përshkrim shumë më i saktë i asaj
9 me të cilën po merreshim ne.

10 Në një moment të caktuar kam shkuar në Tiranë dhe kam
11 takuar dikë që na ishte përshkruar neve si udhëheqësi i UÇK-
12 së, kreu i UÇK-së. Përfundimi im dhe përfundimi i kolegëve të
13 mi ishte se: Po, natyrisht se ai vepron brenda kësaj
14 lëvizjeje, por, jo, nuk mund të flasë në emër të UÇK-së.

15 Pastaj vazhduam të punojmë në përpjekje për të gjetur
16 njerëz me të cilët mund të flisnin si përgjegjës për këtë. Dhe
17 në një moment, po shkonim në qytetin e Likovcit, më duhet ta
18 verifikoj këtë saktësisht, por e gjitha kjo ka ndodhur në verë
19 dhe vjeshtë të 1998, pra, përpjekjet tona për të gjetur një
20 bashkëbisedues.

21 PY. Që të kalojmë hap pas hapi. Kontakti i parë që ju
22 përmendët ishte në Tiranë, a ju kujtohet emri i individit që u
23 takuat me të?

24 PË. Po ma dhatë ju emrin ndoshta do të më kujtohet. A keni
25 një emër?

1 PY. Do t'jua lexoj deklaratën, pra, shënimin përgatitor.

2 PË. Në rregull.

3 PY. Shënimi përgatitor që kemi bërë bashkë.

4 PË. Okej. Në rregull. Kërkoj ndjesë.

5 PY. Është paragrafi 7 dhe ndoshta ju freskon kujtesën:

6 "Ambasadori Hill konfirmoi se informacioni i dhënë në

7 këtë intervistë është i saktë dhe se kontakti i tij i parë me

8 UÇK-në ka qenë në Tiranë në qershor të 1998-s me Xhavit

9 Halitin" --

10 PË. Saktë.

11 PY. -- me emër, me pseudonim "Zeka".

12 PË. E saktë.

13 PY. Tani, a erdhi ndonjë moment, a ndodhi ndonjë moment që ju

14 diskutuat me njerëzit e UÇK-së qoftë në Kosovë apo me njerëzit

15 e UÇK-së në Zvicër nëse kishin autoritet për të folur në emër

16 të saj?

17 PË. Nuk më kujtohet të kem bërë bisedime apo diskutime me

18 UÇK-në në Kosovë lidhur me grupin në Zvicër. Nuk më kujtohet

19 të kem bërë diskutime. Nuk më kujtohet të kem patur diskutime

20 me shqiptarë të ndryshëm në Kosovë dhe përfundimi ishte: Jo,

21 këta njerëz në Zvicër nuk janë përgjegjës të UÇK-së.

22 PY. Dhe ju keni dëshmuar lidhur me një takim me UÇK-në në

23 Likovc. Por përpara kësaj, a ka ndodhur në ndonjë moment të

24 caktuar që Ambasadori Holbrooke është takuar me dikë nga UÇK-

25 ja?

1 PË. Po edhe pse domethënia e asaj është ekzagjeruar në atë
2 kohë, ne kemi dalë dhe kemi shkuar në një zonë që ishte
3 sulmuar nga serbët dhe miqtë tanë kosovarë donin që ne të
4 shihnim këtë vend dhe të bisedonim me njerëzit aty. Ishte
5 fshat ku mund të shkonim duke përdorur rrugën kryesore, emri i
6 fshatit ishte Junik.

7 Dhe ndërkohë që po flisnim me bujqit e ndryshëm dhe të
8 gjithë tregonin përvojat e tyre të vështira aty, përballeshin
9 me forcat e sigurisë serbe, një person hyri aty me një mjekër
10 të madhe dhe me uniformë kamuflazh, Holbrooke më tha mua dhe
11 të tjerëve se ai dukej si Che Guevara. Dhe është e drejtë të
12 themi që ai person, atij personi i pëlqenin mediat, ne ishim
13 të gjithë të ulur në tokë, në dysHEME, po pinim çaj dhe po
14 bisedonim me këta bujq shqiptarë dhe ky person hyri brenda dhe
15 s'kishte vend midis me vendin ku ishte Holbrooke dhe meje, po
16 ai gjeti një farë vendi, u ul aty afër Holbrooke, gati në
17 gjunjët e tij, në prehër të tij. Dhe u bë një fotografi aty,
18 që e cila pastaj u shpërnda gjithandej dhe dukej sikur
19 Holbrooke kishte patur kontakt me UÇK-në. Më vonë pastaj ne
20 kuptuam që ai ishte një pjesëtar i UÇK-së i vetëshpallur, por
21 që nuk ishte udhëheqësi i saj në asnjë formë në asnjë mënyrë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në 3.30 do
23 bëjmë pushimin e parë. Pra, do bëjmë 15 minuta pushim për të
24 gjitha palët.

25 Z. MISETIC: [Përkthim]

1 PY. Përmendët se në takim me UÇK-në në Likovc, përmendët një
2 takim në Likovc?

3 PË. Po.

4 PY. Ju kujtohet kush ka udhëtuar me ju në atë takim?

5 PË. Po. Fehmi -- ka qenë një Fehmi, më duket se në këtë takim
6 ka qenë një pjesëtar i LDK-së, Fehmi Agani. Dy shqiptarë të
7 tjerë të njohur, Veton Surroi, gazetarë kanë qenë, ishte njëri
8 syresh dhe Blerim Shala personi i dytë. Dhe me mua në sediljen
9 e pasme të automjetit të madh ka qenë Tina Kaidanow dhe
10 Phillip Reeker.

11 Nuk jam 100 për qind i sigurtë nëse ka qenë Fehmi Agani
12 në këtë udhëtim apo ka qenë në një udhëtim tjetër.

13 PY. Kush janë këta atëherë Tina Kaidanow dhe Phil Reeker?

14 PË. Tina ka qenë asistentja ime dhe e njihte shumë mirë
15 Ballkanin. Ishte punonjëse e Shërbimeve të Huaja asokohe, sapo
16 kishte filluar detyrën dhe detyra e saj ka qenë Beograd dhe
17 ishte shumë efikase dhe ishte asistentja ime.

18 Phillip Reeker ka qenë zëdhënësi im për shtyp në
19 ambasadën në Shkup asokohe i cili më shoqëroi në këto udhëtime
20 në Kosovë dhe më pas njësoj si Tina, bashkë me Tina kemi
21 shkuar në Rambuje.

22 PY. A mund të na thoni pse shkua në Likovc në këtë rast ju?

23 PË. Mesa më kujtohet kemi shkuar që të përpiqeshim të
24 kuptonim më mirë kush e drejtonte UÇK-në edhe si t'i joshnim
25 që t'i bënim pjesë të një procesi politik.

1 PY. Do t'ju tregoj një fragment të një libri. Por fillimisht
2 do ju pyes nëse ju kujtohet që keni dhënë një intervistë të
3 gjatë për Blerim Shalën gjatë kohës që keni qenë ambasador në
4 Poloni në 2002?

5 PË. Më kujtohet që kam dhënë një intervistë të gjatë. Nuk më
6 kujtohet të ketë qenë më e gjatë, më e gjatë se ajo çka
7 shkruar ai më vonë në fakt.

8 PY. Do t'ju lexoj një fragment të intervistës.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të vendosë në
10 ekran DHT12206 deri në DHT02372 në faqen DHT12274.

11 PY. Përpara se të shikojmë fragmentin, e njihni Mehmet
12 Hajrizin?

13 PË. Jo, nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet.

14 PY. Në rregull. Atëherë ta shohim se mbase ju ndihmon me
15 kujtesën ky fragment. Pretendohet që këtu keni folur ju me
16 Blerim Shalën. Thuhet, diku në krye nga mesi:

17 "Koha po ikën dëm ...". Thuhet "Koha po ikën dëm ..."

18 PË. Më falni. "Për Hajrizin ...". Këtu kur flitet në vetë të
19 parë jam unë?

20 PY. Po, jeni ju. Shikoni rreshtin ku fillon: "Koha po ikën
21 ..."

22 PË. "Koha po ikën dhe personat po humbasin shtëpitë ..."

23 PY. Lexojeni ju me zë atëherë që të mos ta lexoj unë.

24 PË. Më duhet t'ju them që nuk më kujtohet personi. Po më
25 kujtohet që jam përpjekur që të formojë një ekip negociues dhe

1 të gjeja persona që do të pranoreshin në komunitetin shqiptar.
2 Dhe mendova se kjo ishte urgjente sepse kishim një draft
3 autonomi, një dokument që ishte thjesht draft, po nuk po
4 arrinim ta negocionim sepse nuk përfshihej askush. Dhe prandaj
5 do të formonim një ekip dhe të mos ishim në një situatë që të
6 angazhonim persona të cilët nuk do të prodhonin rezultate.

7 Pra, ishte një frustim i vazhdueshëm që të gjenim persona
8 që të flisnin dhe në emër të të tjerëve.

9 PY. Flasim sërish për udhëtimin e Likovcit.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në fund të faqes.

11 PY. Rreshti i katërt nga poshtë, ku thuhet "Mehmeti ...".

12 Pra:

13 "Mehmeti ra dakord që të përpigeshim të bënim diçka të
14 nesërmen. Të nesërmen në vend që të shkonim në drejtim të
15 jugut shkuam në drejtim të veriut dhe në një rreth-rrotullim
16 morëm drejtimin për të shkuar nga Lugina e Drenicës në
17 Likovc."

18 PË. Saktë. Më duket se shkuam në Shtime, aty kishte luftime.

19 Në atë udhëtim më kujtohet që Fehmi Agani tha që është
20 provokim prej serbëve ky. Dhe meqë automjeti ynë u godit me
21 plumba, ishte e blinduar fatmirësisht automjeti, po na goditën
22 me armë. Po Fehmi Agani tha "Në qoftë se ky është provokim,
23 atëherë janë shumë të zotë, kështu që ne do ta ndërpresim këtu
24 udhëtimin". Dhe ne gjetëm një shteg tjetër për të shkuar në
25 Shtime.

1 Pra, kjo ishte vetëm që të shkonim në Likovc, të flisnim
2 me personat atje që të përfaqësonin ata një grupim më të
3 gjerë.

4 PY. Shikojmë pjesën tjetër të tekstit ku thuhet "Teksa vijua
5 ..."

6 "Teksa vijua rrugën pamë një eskortë të UÇK-së na
7 shoqëruan në rrugët me baltë. Mund të shihnim me qindra
8 familje me traktorët e tyre, me kamionët e tyre të ngarkuara
9 me sendet e familjes të cilët përpiqeshin t'u largoheshin
10 luftimeve."

11 Po ndaloj për një çast.

12 A ju ndihmon kjo me kujtesë, pra, që është bërë një takim
13 para ose pas luftimeve të serbëve të korrik të 1998?

14 PË. Ka qenë pas. Pas.

15 PY. Vazhdojmë:

16 "Pra, pamë me qindra persona më në fund arritëm në zyrat
17 e UÇK-së ku pamë që ishim më të interesuar në pjesën
18 ceremoniale sesa në gjërat e tjera praktike. Kishin flamuj,
19 kishin roje".

20 Përputhet kjo me kujtesën tuaj?

21 PË. Po, përputhet.

22 PY. Vijon:

23 "Hymë në një dhomë që kishte një tryezë të mbushur në
24 ngjyrë të gjelbër, kishte pije në qendër të tavolinës, sikurse
25 të ishte ndonjë takim zyrtar që do të ndodhte në shtetet e

1 NATO-s dhe personat atje vishnin uniforma."

2 PË. Po, ishte një tavolinë e gjelbër. Kishte në fakt, ishin
3 shishe uji mineral. Ishte një përpjekje nga ana e tyre për të
4 treguar që ky është një takim normal me persona ushtarakë.

5 PY. Ju thoni:

6 "Ne u ulëm dhe ju drejtova Hajrizit dhe i thashë: 'Dëgjo,
7 Mehmet tani është radha juaj, vazhdoni'. Mehmeti u kthye dhe
8 tha, në fakt do të doja që ta drejtonit ju takimin. Dhe unë
9 mendova me vete, meqë kam ardhur deri këtu me automjet,
10 atëherë po e bëj dhe takimin nëse është nevoja."

11 PË. Po, po. Kështu ka qenë. Dhe më kujtohen në fakt edhe
12 gjëra të reja tani. Më kujtohet. Tani po më kujtohen gjërat.
13 Më kujtohet kush ka qenë Mehmeti tani. Mehmeti supozohej se
14 ishte person më aktiv edhe unë mendova se do ishte aktiv në
15 takim, por ai në fakt mu drejtua mua sepse askush nuk donte të
16 merrte kurrfarë përgjegjësie dhe të thoshte diçka që mund të
17 nënkuptonte se duhet të përfshiheshin për një dokument që nuk
18 përmbushte objektivat e tyre.

19 PY. Pastaj ju thoni:

20 "I bëra kërkesë UÇK-së që ne donim që ristrukturonim
21 qeverinë dhe do na duhej një kryeministër i ri me Mehmet
22 Hajrizin këtu, por qëllimi i vërtetë i kësaj gjëje ishte që të
23 fillonim procesin negociues, të kishim armëpushim, pra, të
24 kishim tamam proces negociues."

25 PË. Po, sepse situata ishte e atillë. Unë e përmenda edhe

1 Rugovën si president sepse ekzistonte një strukturë në
2 vetvete. Serbët e thonin që është një strukturë e stisur por
3 në fakt për shqiptarët kjo ishte një qeveri, ishte një
4 strukturë qeveritare në pikëpamjen e tyre.

5 Pra, ideja ishte që të zgjerohej kjo strukturë qeveritare
6 ku të përfshiheshin grupe të ndryshme dhe të mos ishte vetëm
7 LDK-ja si grup i vetëm në këtë strukturë. Unë nuk mendova se
8 ishte e gabuar kjo në vetvete, por unë isha më interesuar që
9 të kisha persona pjesëmarrës në negociata e jo persona që
10 donin thjesht të ishin pjesë e një strukture qeveritare që nuk
11 do ta njihte asnjë palë ose më saktë desha të thoja asnjë
12 subjekt i huaj nuk do ta njihte.

13 PY. Vijon:

14 "Pra, UÇK-ja, personi përgjegjës, Rexhep Selimi tha: Ju
15 faleminderit shumë, do t'ia përcjellim këto shefit të shtabit.
16 Unë i thashë, shumë mirë, po unë mendova se ju ishit shefi i
17 shtabit, prandaj kam ardhur unë këtu. Ju e dini që ne na
18 goditën me plumba në automjetin tonë kur erdhëm këtu, hymë në
19 terrene të vështira, u ekspozuam ndaj të shtënave prej armëve,
20 pamë refugjatë që shkonin gjithandej dhe ju po më thoni mua
21 tani që nuk jeni ju personi që do merrni vendimin. Ai u
22 përgjigj, jo nuk jam unë. Nuk është nevoja të them sa u
23 zhgënjeva unë nga kjo situatë. Dhe unë e pyeta, kur mund ta
24 marrim vendimin tuaj. Ai u përgjigj, mbase javën tjetër. Unë i
25 thashë, jo, javën tjetër është shumë vonë, duhet të veprojmë

1 më me shpejtësi."

2 Pra, përputhet kjo me kujtesën tuaj si ka qenë biseda me
3 Rexhep Selimin?

4 PË. Po, në fakt shumë. U acarova shumë kur na thanë që duhet
5 -- fillimisht më thanë që do të takoheshim me një person që do
6 të merrte një vendim por në thelb askush nuk donte të merrte
7 asnjë lloj përgjegjësie për asnjë diskutim të vërtetë. Dhe për
8 ne ishte e vështirë të shkonim atje. u përpoqëm shumë. Nuk
9 kisha siguri me vete, nuk më shoqëronte askush, siguria e
10 Departamentit të Shtetit nuk do të ishte entuziaste për këtë
11 udhëtim, nuk do ta miratonte këtë udhëtim sepse patëm dhe
12 situatën ku e goditën automjetin me plumba, madje ne nuk e
13 raportuam fare këtë situatë kur pamë shenjat në fund të
14 automjetit që na kishin gjuajtur me armë.

15 Pra, ne ndërmorëm një rrugë të rrezikshme si nga
16 pikëpamja personale, nga pikëpamja burokratike për të takuar
17 një person që na tha do e përcjellim mesazhin tuaj.

18 Duhet të kuptoni në rrethana të tilla përpiqesh të bësh
19 të pamundurën dhe ndonjëherë është frustruese kur mendon që
20 pala tjetër s'po bën të pamundurën, sepse në fakt duhet të
21 ishte më e rëndësishme për ta të gjendej një zgjidhje sesa për
22 ne.

23 PY. Ju vijoni më pas dhe thoni:

24 "Ndërkohë Mehmet Hajrizi nxori një copë letër në të cilën
25 shkruheshin ndryshimet në qeveri dhe përfshihej dhe tërheqja e

1 Rugovës ose më saktë do të kërkohej që ai të largohej.”

2 Ju kujtohet që Mehmet Hajrizi të ketë kërkuar largimin e
3 Rugovës në këtë takim?

4 PË. Unë mbaj mend që kishte shumë frustrim për shkak se
5 kishte monopolin LDK-ja nga pikëpamja e shqiptarëve të Kosovës
6 dhe kjo u pasqyrua në fakt. S’po e quaj të ashtuquajtur qeveri
7 sepse për njerëzit ishte një qeveri, por ishte një qeveri që
8 personat në LDK mendonin se nuk po përfaqësonte tamam
9 pikëpamjet e tyre. Këta persona donin që ta zgjerinin
10 qeverinë, ta shtrinin qeverinë.

11 Unë e mora më shumë këtë si metaforë, për mua kjo ishte e
12 rëndësishme të gjenim persona që mund të negocionin lidhur me
13 dokumentin, me projekt-dokumentin, kështu që unë e pranova
14 idenë që po përpiqeshim të formonim një qeveri më
15 gjithëpërfshirëse por problematika e vërtetë ishte e
16 rëndësishme të kishim një ekip negociues i cili të
17 përfaqësonte të gjitha pikat që do diskutoheshin në këtë
18 projekt-dokument.

19 PY. Në rregull. Po vazhdoj duke lexuar paragrafin e fundit ku
20 thuhet:

21 “Për mua ishte e qartë se Hajrizi nuk ishte në gjendje që
22 t’i drejtohej UÇK-së në atë pikë, për mua ishte një zhgënjim i
23 madh sepse kisha punuar shumë që të pranohej ai si
24 kryeministër. Fillimisht mendova se ai mund t’u drejtohej
25 atyre, më pas mendova se mbase do komunikonte me ata pasi të

1 takohesha unë me UÇK-në që në fakt ishte e gabuar. Isha shumë
2 i shkurahtar kur u largova dhe u binda se nuk kishim luksin të
3 prisnim që këta personat që të gjenin kush është Shtabi i
4 Përgjithshëm dhe nëse mund të merrnin lejen prej tyre. Ishte e
5 qartë për mua që ne nuk kishim raportues në këtë pikë,
6 relatorë. Në këtë pikë më duhej të merrja një vendim
7 strategjik. Në këtë pikë ne filluam të hartonim draftet tona,
8 versionet tona të para të dokumenteve."

9 Në këtë fragment thoni që "u larguat goxha i shkurahtar
10 nga takimi dhe u bindët se nuk kishit më luksin të prisnit ju
11 për këta personat që të gjenin e të zbulonin se kush ishte
12 Shtabi i Përgjithshëm edhe nëse Shtabi i Përgjithshëm do t'u
13 jepte lejen".

14 Në këtë pikë a besonit vërtetë ju se ekzistonte një
15 Shtabi i Përgjithshëm përgjegjës për UÇK-në?
16 PË. Jo, nuk e besoja këtë gjë. Unë mendoj se është shumë,
17 ishin më shumë ishin përpjekje për të treguar që ekziston një
18 ushtri në mënyrën tradicionale me hierarkinë vertikale dhe
19 ishte thjesht një përpjekje nga ana e tyre për të na treguar,
20 sikurse na tregonin personat që ekzistonte qeveria, pra, ishte
21 një orvatje për të na treguar ne që ne kemi struktura normale
22 politike e ushtarake dhe se ne duhet t'i merrnim seriozisht.
23 Sidoqoftë, sikurse duket në këtë paragraf, ne nuk morëm asnjë
24 gjë prej tyre. Më shumë personat përpiqeshin të na tregonin se
25 ishin më të rëndësishëm seç ishin në realitet.

1 Pra, ishte shkurajuese në të vërtetë, por më duhet të
2 shtoj diçka që në fakt nuk është tamam e lidhur me pyetjen
3 tua, unë pikëpamjet e mia ua bëra të qarta disa personave
4 lidhur me këtë aspekt, pra, u thashë që nuk kam frikë se po
5 kërkojmë diçka që nuk ekziston.

6 PY. Ambasador Hill, në këtë pikë a mendonit ju se UÇK-ja
7 ishte një strukturë vertikale me organizim hierarkik?
8 PË. Jo.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar z. Kryegjykatës, dua të
10 pranohet ky fragment i librit të Shalës, ballina edhe faqet që
11 ia paraqita dëshmitarit. Numri është DHT12206 deri në
12 DHT12372. Dhe do kërkojmë të pranohet faqja DHT12206 si
13 ballinë dhe më pas faqja DHT12274 deri në DHT12275.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
15 kundërshtime nga Ekipet e tjera të Mbrojtjes? Jo.

16 Prokuroria ka kundërshtime?

17 Z. PACE: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull
19 atëherë. Nga materiali me numër DHT12206-DHT12372 ku DHT12206
20 është ballina dhe DHT12274-12275 pranohen.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra edhe
23 ballina edhe fragmentet përkatëse pranohen.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Ballina
25 dhe faqet përkatëse do të marrin numrin e provës materiale

1 1D00423 dhe klasifikimi është publik.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem tani të shohim një pjesë
3 tjetër të këtij libri, DHT12206-DHT12372 në faqen DHT12292.
4 Faleminderit. Shkojmë më poshtë.

5 PY. Ambasadori Hill, kjo është një pjesë tjetër e intervistës
6 ku z. Shala ju ka pyetur si në vijim:

7 "Në atë kohë e dinit ju kush ishte përgjegjës për UÇK-në?
8 Kush ishte figura më e rëndësishme në UÇK?"

9 Ju i jeni përgjigjur si në vijim:

10 "Të kërkohej personi përgjegjës të UÇK-së ishte e
11 pamundur. Sepse ekzistonin grupe të ndryshme personash, ishte
12 grupi i Dukagjinit, ishin persona nga Drenica, kishte
13 komandantë të ndryshëm zonash, kishte persona të rëndësishëm
14 që merreshin me logjistikën si Xhavit Haliti, kishin persona
15 që merreshin me financën në vendet perëndimore. Pra, nuk
16 mendoj se kishte, ekzistonte një numër i vetëm telefoni
17 satelitor që ne mund ta thërrisnim. Pra, ekzistonin persona ë
18 ndryshëm, prandaj ishte kaq e vështirë të flisje me këta
19 persona të ndryshëm ndonëse kur bisedoje me ta më shumë i
20 ngatërronim sesa u jepnim ndonjë informacion. Pra, filluam të
21 kuptonim se ekzistonte më shumë se një politikë dhe në një
22 farë mënyre kjo i dha shtysë paranojës serbe që SHBA-ja po
23 flet për të nënshkruar një marrëveshje, planin Hill, përqasja
24 e vërtetë e SHBA-së është të ndihmojë UÇK-në që të kenë fitore
25 nga pikëpamja ushtarake, e kështu e kështu. Pra, filloi të

Dëshmitari: Christopher Hill (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 45

1 ekzistonte kjo lloj paranoje.”

2 A përputhet kjo me vlerësimin që keni bërë ju për UÇK-në
3 asokohe?

4 PË. Po. Ky fragment përputhet tërësisht në fakt me vlerësimin
5 tonë sa i takon UÇK-së dhe po ashtu pasqyronte në fakt
6 frustrimin tonë për faktin që nuk po gjenim një person me të
7 cilin mund të komunikojmë.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Misetic, ju lutem mund të
9 bëni disa sqarime për periudhën kohore kur thuhet në pyetje
10 “ajo periudhë” për cilën periudhë bëhet fjalë në pyetjen e z.
11 Shala?

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

13 PY. Ambasadori Hill, e dëgjuat pyetjen, për cilën periudhë
14 bëhet fjalë?

15 PË. Besoj fundi i verës, fillimi i vjeshtës 1998.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar z. Kryegjykatës, kërkoj
18 pranimin e kësaj faqeje dhe do ju lutesha që t’i
19 bashkëngjitej 1D00423. Kjo është faqja 12292.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
21 kundërshtime?

22 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
24 Materiali DHT12292 pranohet, do t’i bashkëngjitet materialit
25 që sapo u pranua.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faqja do t'i

2 bashkëngjitet provës me numër 1D00423 dhe ka klasifikim
3 publik.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem tani të shohim videon me
5 numër 129503 deri në pjesën që mbaron me 12, do ta shohim nga
6 minuta 37:26 këtë video. Faleminderit.

7 PY. Ambasadori Hill, do shohim një video të një fjalimi që
8 keni mbajtur ju në Washington D.C, në qendrën Woodrow Wilson
9 edhe më pas do ju pyes nëse përputhet kjo që keni thënë me atë
10 që ju kujtohet sot lidhur me vlerësimin për UÇK-në.

11 PË. Në rregull.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne jemi më shumë të interesuar te
13 videoja nuk jemi të interesuar tek transkripti.

14 [Luhet videoincizimi]

15 Nuk ka përkthim.

16 Z. MISETIC: [Përkthim]

17 PY. Ambasadori Hill, kjo që thatë në këtë ngjarje përputhet
18 me vlerësimin që kishit ju për UÇK-në asokohe?

19 PË. Po, shumë, po në kuptimin që ne shpresonim se do të ishte
20 një proces më gjithëpërfshirës, por kjo do të ndodhte vetëm
21 kur personat të kuptonin se po shkonte në drejtimin e duhur.
22 Pra, po.

23 PY. Kur thoni që nuk mund ta sillni UÇK-në në tryezë përveç
24 nëse keni një tryezë shumë të madhe, çfarë keni dash të thoni
25 ju këtu?

1 PË. Kam dash të them që do të kishim mendime të ndryshme,
2 kështu që në një tryezë të vogël ne mund të kishim një
3 përfaqësues që të përfaqësonte një grup të gjerë, që do të
4 kishim një tryezë të madhe me shumë pjesëmarrës.

5 PY. Faleminderit.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj të pranohet videoja si
7 provë gjyqësore.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtime?

9 Z. PACE: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
11 Materiali -- si përfundonte, s'e mbaj mend?

12 Z. MISETIC: [Përkthim] 37:41. 38:09 aty përfundoi
13 segmenti.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull
15 pranohet segmenti kohor 37:41 deri në 38:09.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Atëherë
17 ky segment i videos nga minuta e 37:26 deri në 38:09 do të
18 marrë numrin e provës materiale 1D00424. Dhe klasifikimi është
19 konfidencial?

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, mund të jetë publik.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
22 Riklasifikoheni ju lutem.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

24 Z. MISETIC: [Përkthim]

25 PY. Ambasadori Hill, në verën e 1998, z. Rugova a identifikoi

1 anëtarë nga pjesa e shqiptarëve të Kosovës që të ishin

2 pjesëmarrës në ekipin negociues?

3 PË. Nuk më kujtohet. Ndodhi në një moment, ai nuk hezitonte

4 të jepte emra të personave nga grupi i tij. Nuk kishte shumë

5 vullnet të jepte emra të personave që nuk ishin pjesë e LDK-së

6 sidoqoftë.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund t'i rifreskoj kujtesën

8 dëshmitarit, ju lutem?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër.

10 Z. MISETIC: [Përkthim]

11 PY. Ambasadori Hill, në paragrafin 23 të përmbledhjes së

12 dëshmisë suaj, po 23 është, ju keni thënë si në vijim:

13 "Prandaj Hill kontaktoi Rugovën, i cili ra dakord të

14 caktonte anëtarë të LDK-së për ekipin negociues, çka e bëri në

15 gushtin e 1998."

16 Ka ndodhur kështu?

17 PË. Po, Rugova nuk e kishte problem të jepte emrat e

18 anëtarëve të LDK-së.

19 PY. A ju kujtohet nëse UÇK-ja po ashtu ju dha emra se kush do

20 të negocionte në emër të UÇK-së? Mund t'ju rifreskoj kujtesën

21 nëse është nevoja.

22 PË. Ju lutem, më rifreskoni kujtesën.

23 Më kujtohet që UÇK-ja ishte e mërzitur për mënyrën sesi u

24 frustrava unë për situatën në Likovc dhe thanë disa gjëra por

25 nuk më kujtohet konkretisht se çfarë kanë thënë.

1 PY. Në rregull atëherë.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem të shohim në ekran provën
3 materiale me numër 1D50. Të shohim anglishten ju lutem.

4 PY. Ambasador, kjo është një deklaratë politike që
5 pretendohet se është shkruar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-
6 së, Drejtoria Politike, "Deklarata Politike numër 7" me datën
7 13 gusht 1998, përafërsisht në periudhën kur z. Rugova caktoi
8 anëtarët e LDK-së. Shihni ju lutem paragrafin e tretë nga
9 lartë, thuhet:

10 "... Shtabi i Përgjithshëm i bën të njohur publikut, bën
11 publik se Jakup Krasniqi, Xhavit Haliti, Bardhyl Mahmuti,
12 Hashim Thaçi, Faton Mehmetaj dhe Sokol Bashota janë
13 përfaqësuesit politikë të UÇK-së. Dalja publike e
14 përfaqësuesve politikë të UÇK-së lehtëson bashkërenditjen e
15 veprimtarisë politike në rrafsh kombëtar."

16 Më pas tek paragrafi i fundit thuhet:

17 "Me qëllimin e shpejtimit të procesit të krijimit të
18 institucioneve të Kosovës, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë
19 Çlirimtare të Kosovës i jep besimin e plotë Adem Demaçit që të
20 marrë rolin udhëheqës në këtë proces. Që Ushtria Çlirimtare e
21 Kosovës duke qenë jashtë çdo ombrelle partiake kërkon nga Adem
22 Demaçi të tërhiqet nga veprimtaria partiake."

23 Ju kujtohet kjo deklaratë?

24 PË. Nuk më kujtohet, jo. Nuk më kujtohet. Adem Demaçi
25 përpigjej të fliste shpesh në emër të UÇK-së dhe besoj se kjo

1 është një përpjekje për të sqaruar më shumë rolin e tij pranë
2 UÇK-së. Por më kujtohet shumë mirë kjo situatë, por në
3 kuptimin që UÇK-ja e dinte se ne ishim shumë të zhgënjyer me
4 paaftësinë e tyre për të na dhënë emrat e personave që do të
5 ishin në ekipin negociues dhe kjo ishte një përpjekje nga ana
6 e tyre që po përpiqeshin. Por unë mendova më shumë që kjo
7 ishte një komunikim për publikun.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gati për
9 pushimin?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe një pyetje.

11 PY. Ambasadori Hill, kjo deklaratë është rreth tri javë
12 përpara deklaratës që sapo pamë ne që bëtë ju në qendrën
13 Woodrow. Në këtë kontekst, bazuar në përgjigjen tuaj të
14 fundit, a mund të na thoni atëherë sa e besueshme ishte për ju
15 kjo bisedë.

16 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj. Sepse dëshmitari tha mua
17 s'më kujtohet deklarata.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet
19 kundërshtimi.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull atëherë.

21 PY. Ndonjë prej këtyre emrave që përmenden në këtë deklaratë
22 ju thonin gjë deri në 4 shtator, i konsideruat ju këta persona
23 në 4 shtator si persona që flisnin në emër të UÇK-së?

24 PË. I njoh disa prej emrave. Po nuk mendoj se kanë folur në
25 emër të UÇK-së. Dhe vetëm në 1999 patëm vërtetë përfaqësues ku

1 u kuptua që në fakt situata nuk kishte vijuar më tej.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
3 15 minuta pushim. Do të kthehemi pas 15 minutash dhe do
4 vazhdojmë deri në orën 5.00 sikurse ju thamë edhe më herët.

5 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
7 shoqëroheni.

8 DËSHMITARI: [Përkthim] Vetëm unë do të bëj pushim?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, jo, duhet
10 të dilni ju i pari nga salla.

11 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
13 Bëjmë 15 minuta pushim.

14 --- Pauza fillon në orën 15.32

15 --- Seanca rifillon në orën 15.47

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
17 Sekretare, mund ta sillni dëshmitarin në sallë.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, ne po flisnim për
19 Deklaratën Politike numër 7 përpara sesa të merrnim pushimin,
20 do kërkoj që t'i rifreskoja kujtesën dëshmitarin duke ju
21 referuar atij në paragrafin 23 të përmbledhjes së dëshmisë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kujt
23 përmbledhje?

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Përmbledhjes së dëshmisë së
25 dëshmitarit.

Dëshmitari: Christopher Hill (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 52

1 [Dëshmitari vijon dëshminë]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi gati për
3 të vijuar më tej, Dëshmitar. Z. Misetic do vazhdojë me pyetjet
4 e veta.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryegjykatës.

6 Znj. Sekretare, do ju lutesha të paraqisnit në ekran
7 dokumentin DHT12160 deri në DHT12169 në faqen DHT12163.
8 PY. Ambasadori Hill, besoj që ju kujtohet që ne po diskutonim
9 lidhur me Deklaratën numër 7, përpara sesa të merrnim pushimin
10 e shkurtër dhe po diskutonim lidhur me përfaqësuesit e UÇK-së,
11 apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Dua që të shohim paragrafin 23 për të parë në qoftë se ju
14 rifreskohet kujtesa. Në paragrafin 23 ju thoni:

15 "Për pasojë, Hill kontaktoi Rugovën i cili ra dakord që
16 të caktonte anëtarët e LDK-së për ekipin negociues i cili do
17 mblidhej në mes të gushtit 1998. Kjo e bëri UÇK-në që të bënte
18 një njoftim disa orë më pas dhe Adem Demaçi dhe disa persona
19 të tjerë mund të vepronin në emër të UÇK-së. Hill tha se deri
20 në një farë mase këta persona e kishin caktuar veten, pra,
21 ishin të vetëcaktuar si përfaqësues të UÇK-së dhe nuk kishte
22 besim tek vërtetësia e asaj çfarë kishte thënë Demaçi."

23 A është e vërtetë kjo, a ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

24 PË. Po.

25 PY. Ambasador, a keni ndonjë përfundim juve mbështetur në

1 diskutimet ose kontaktet që keni pasur me UÇK-në nga viti 1998
2 deri në vitin 1999 lidhur me objektivat e UÇK-së?
3 PË. Nuk është se i njihja vërtetë se kush ishin ata, kështu
4 që është e vështirë për mua për të thënë se çfarë objektivash
5 kishin ata. Ishte e vështirë që të kishim takime të
6 përnjëmendta me përfaqësuesit e tyre. Por pa diskutim ata,
7 domethënë, nga personat me të cilët ne kemi biseduar,
8 ekzistonte pikëpamja që nuk mund të negociohej me serbët dhe
9 për rrjedhojë ajo çfarë dëshironin ata të realizonin ishte që
10 të realizohej pavarësia dhe që ne t'i ndihmonim ata që të
11 sigurohej pavarësia.

12 PY. A t'u krijua përshtypja -- do t'ju bëj një pyetje tjetër
13 në fakt, Ambasador, mbështetur në përgjigjen që sapo na dhatë.
14 A ju krijua përshtypja në qoftë se UÇK-ja kishte ndonjë
15 objektiv afatgjatë sa i takon përfshirjes së Shteteve të
16 Bashkuara?

17 PË. Ata ishin të interesuar që të punonin me Shtetet e
18 Bashkuara sepse ata mendonin që Shtetet e Bashkuara ishin në
19 pozitë që të realizoheshin objektivat e tyre që ishte
20 pavarësia afatmesme për Kosovën.

21 PY. A t'u krijua ndonjë përshtypje në qoftë se UÇK-ja kishte
22 si objektiv armëpushim në Kosovë për vete, domethënë, a mund
23 ta realizonte këtë gjë vetë UÇK-ja?

24 PË. Unë, mu krijua përshtypja që ata nuk ishin të interesuar
25 që të punonin me LDK-në dhe ata bënë çfarë mundën në mënyrë të

1 tillë që të prishnin reputacionin e LDK-së. Në vend që të
2 ishte Rugova si zëri i shqiptarëve të Kosovës, ata vetë donin
3 që të ishin zëri i shqiptarëve të Kosovës, por nga ana tjetër
4 ishte e vështirë që zëri i Kosovës të ishin personat të cilët
5 nuk njiheshin. Kështu që mendoj që zëvendësimi i Rugovës dhe
6 përfaqësimi i tyre si zë për të folur për Kosovën dhe për
7 pavarësinë e Kosovës ishte një prej objektivave të tyre.
8 PY. A keni dëgjuar ndonjëherë ndonjë objektiv ose ndonjë
9 synim fundor të UÇK-së që UÇK-ja vetë të drejtonte Kosovën?
10 PË. Nuk është se e kam dëgjuar këtë konkretisht, por ajo
11 çfarë kam dëgjuar është që ata donin autonomi, donin që të
12 ishin të pavarur dhe që ata donin ta arrinin pavarësinë dhe
13 mendonin që arritja e pavarësisë do të ishte më e thjeshtë në
14 qoftë se do të punonim me amerikanët
15 PY. Tani duke ju kthyer objektivave tuaja a besoni ju se
16 mund të shkruanit një propozim që do të ofronte pavarësinë e
17 shqiptarëve të Kosovës?
18 PË. Jo. Dhe arsyeja për këtë ishte se unë kisha biseduar me
19 anën serbe dhe ata nuk kishin pikë interesi për të punuar për
20 përpilimin e një dokumenti që do të çonte në pavarësi. Dhe
21 duke u përpjekur që dy mendime krejtësisht të kundërta të mund
22 të silleshin afër njëri-tjetrit, mua, mendoja unë, që do ishte
23 më mirë që të fitohej autonomia për Kosovën megjithëse
24 autonomia që kishin ne parasysh apo që kishim në mendje ishte
25 shumë herë më e gjerë sesa autonomia që ishte përshkruar në

1 kushtetutën e ish-Jugosllavisë të vitit 1974. Ne shpresonim që
2 Kosova do të fitonte autonominë.

3 Dhe shpresonim që, në atë kontekst, BE-ja mund të bënte
4 diçka më tepër lidhur me rrugëtimin e anëtarësimit për vendet
5 e Ballkanit në mënyrë të tillë që çështja e sovranitetit dhe
6 pavarësisht në qoftë se flitej për autonomi apo sovranitet,
7 pra, që çështje të tilla më pas të bëheshin më tepër teorike
8 dhe retorike dhe që të gjithë në fund të ishin anëtarë të
9 Bashkimit Evropian. Kështu që rrugëtimi drejt Bashkimit
10 Evropian donte të thoshte që neve nuk na duhej që të kalonim
11 këto probleme të cilat në atë kohë ne i shikonim kaq të
12 pazgjidhshme, pra dhe të tilla si, për shembull, Kosova të
13 ishte e pavarur apo jo.

14 Në fund unë u përpoqa që t'i përshkruaja njerëzve që
15 qeveria ishte një grup shërbimesh dhe në qoftë se ky grup
16 shërbimesh mund të ofroheshe prej tyre jo nga subjekte të
17 huaja, pra, ju mund të keni një autonomi të plotë dhe në qoftë
18 se do të jeni pjesa e një strukture më të gjerë si, për
19 shembull, Bashkimi Evropian, nuk duhej që të ishin kaq shumë
20 të përqendruar tek çështje e sovranitetit që lidheshin me
21 shekullin XIX sikurse ju thosha unë në atë kohë. Pra, ky ishte
22 formulimi që përdorja në atë kohë.

23 PY. Si e kuptuat ju pozicionin e z. Rugova dhe të LDK-së? Ata
24 ishin pro autonomisë apo pavarësisë?

25 PË. Ata ishin për pavarësi plotësisht, por ata ishin të

1 përgatitur që të punonin me ne në faza ose në etapa. Ata e
2 kuptonin që kishte dhe një palë tjetër dhe që Serbia duhej që
3 të pajtohej me diçka dhe ata e dinin që Serbia nuk do të
4 pajtohej me pavarësinë për Kosovën.

5 Pra, kjo është një çështje e cila ngrihet edhe gjatë
6 negociatave, pra, kush mund të jetë pak më shumë i arsyeshëm
7 përkundrejt palës që vetëm thjesht ngulë këmbë tek pozicioni i
8 vetë. Mendoj që njerëzit e Rugovës ishin të interesuar për të
9 njëjtin rezultat si UÇK-ja, por ata ishin më të arsyeshëm
10 lidhur me mënyrën sesi do ta arrinin këtë objektiv.

11 PY. A jeni hasur ju me ndonjë kritikë lidhur me ndjekjen e
12 planit të autonomisë dhe jo të pavarësisë, qoftë brenda
13 Kosovës apo jashtë Kosovës?

14 PË. Po, sepse mendohej që në Kosovë ekzistonte mendimi që
15 Shtetet e Bashkuara ishin pro pavarësisë së menjëhershme të
16 Kosovës dhe ky prezumim i qartë i tyre që ne ishim më shumë të
17 interesuar në një marrëdhënie në të ardhmen me Kosovën sesa
18 ishim të interesuar në marrëdhëniet me aleatët tanë të Evropës
19 Perëndimore, për rrjedhojë ne mendoheshim sikur ishim më tepër
20 pro rrugës së pavarësisë së Kosovës sesa rrugës që të punonim
21 me aleatët tanë dhe të punonim për paqen dhe sigurimin në
22 rajon.

23 Pra, njerëzit në Kosovë dhe, në fakt këtë e shikonim
24 rëndomë edhe në shtyp dhe populli i Kosovës, njerëzit në
25 Kosovë ishin të zhgënjyer nga kjo që unë e quaja pragmatizëm,

1 po ata e quanin si një pozicion timin që isha pro autonomisë
2 dhe që objektivi fundor ishte autonomia dhe jo pavarësia e
3 menjëhershme. Domethënë, kishte një lloj zhgënjimi në raport
4 me mua që vinin nga disa anë. Megjithatë personat dhe njerëzit
5 që e kuptonin që ky ishte një problem kompleks dhe që e
6 kuptonin që ky nuk ishte një problem që mund të zgjidhej me një
7 përgjigje po apo jo, e kuptonin që unë po bëja më të mirën e
8 mundshme timen.

9 PY. Faleminderit. Çfarë ju kujtohet ju nga takimi i parë kur
10 jeni takuar me Hashim Thaçin?

11 PË. Më kujtohet që takimi i parë është zhvilluar në një
12 shtëpi, nuk e di në qoftë se mund të më rifreskoni kujtesën
13 për shtëpinë?

14 PY. Në qoftë se ju them që shtëpia ka qenë në Dragobil, ju
15 kujton diçka kjo?

16 PË. Po.

17 PY. A ju kujtohet se kush tjetër ka marrë pjesë në këtë takim
18 në Dragobil?

19 PË. Më kujtohet që Krasniqi, në mos gabohem, ka qenë aty.
20 Kanë qenë dhe tri persona të tjerë.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, a mund t'i kujtoj
22 informacionin dëshmitarit?

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

24 Z. MISETIC: [Përkthim]

25 PY. Për këtë dua t'ju tregoj intervistën në libër me z.

1 Shala.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Sekretare, do ju lutesha të
3 paraqisnit në ekran dokumentin DHT12206 deri në DHT12372. Më
4 konkretisht do ju lutesha të paraqisnit në ekran faqen
5 DHT12287. Do kalojmë drejt fundit të faqes.

6 PY. Tek pyetja e katërt e z. Shala thuhet:

7 "Shala: Në atë periudhë sa më kujtohet ju jeni takuar për
8 herë të parë me z. Hashim Thaçi në Dragobil, ku i keni dhënë
9 propozimin e marrëveshjes së ndërmjetme. Çfarë përshtypje keni
10 pasur nga ky takim i parë, për çfarë kishte të bënte takimi?"

11 Përgjigja që ju jepni është kjo:

12 "Më kujtohet që të gjithë ishin aty ..."

13 Shala thotë:

14 "Ky ishte takimi i parë që keni pasur me të?"

15 Dhe ju i përgjigjeni:

16 "Po, ky ishte takimi i parë."

17 "... takimi i parë zyrtar se ju nuk keni bërë takim jo
18 zyrtar."

19 Përgjigje:

20 "Nuk kujtohet që e kam parë më përpara. Ai ishte i
21 shoqëruar me disa persona të tjerë, përfshirë Jakup Krasniqin
22 dhe një tjetër ..."

23 Pastaj z. Shala ju ndërpretë:

24 "... Sokol Bashota, mendoj, apo jo ..."

25 Ju thoni:

1 "... si e kishte emrin ky personi ..."

2 Shala thotë:

3 "Ramë Buja, që ishte gjithashtu me Thaçin në Rambuje."

4 Ju thoni:

5 "... jo, personi tjetër, ky personi tjetër që ishte hero
6 i madh? Gjithsesi, mua më kujtohet një person që dëshironte që
7 të merrte armën brenda në shtëpi, një burrë i madh. Dhe unë i
8 thashë, domethënë, gjëja e parë që i thashë është që armët nuk
9 duhet të sillen këtu, nuk duhet të sillen brenda. Dhe neve
10 vazhduam dhe diskutuam me UÇK-në. Dhe pjesëmarrësit më thanë
11 që sa njeri i tmerrshëm ishte Rugova dhe unë ju thashë që 'nuk
12 e vras mendjen se çfarë mendoni ju për Rugovën'. Se një ditë
13 kur të keni demokraci do keni kënaqësinë e votimit kundër tij.
14 Por tani duhet të kujdesemi për Rugovën me mjete demokratike
15 dhe meqenëse po flasim për mjete demokratike, për këtë dua që
16 të flasim tani, domethënë, për këtë projekt të dokumentit që
17 po mundohemi të hartojmë. Vazhdova duke thënë që duhet të
18 përqendrohemi tek versioni fillestar i dokumentit dhe ndërkohë
19 ata vazhdonin që të thonin sesa njeri i tmerrshëm ishte
20 Rugova."

21 Shala më tej vazhdon:

22 "Ky ishte diskutimi që organizuat me ta?"

23 Ju përgjigjeni:

24 "Po. Kaq ishte ..."

25 Më pas pyetja tjetër është:

1 "A ia dërguat komentet e tyre palëve të tjera?"

2 A ju kujtohet, Ambasador, se kjo ka qenë biseda që keni
3 organizuar dhe ky ka qenë takimi i parë në Dragobil me z.
4 Thaçi?

5 PË. Po, më kujtohet. Mendoj që është e rëndësishme që të
6 kuptohet që sikurse e diskutuam dhe më herët ekzistonte një
7 perceptim që unë në një farë mënyre isha i afërt me fraksionin
8 ose me palën e Rugovës. Por dua që të kuptoni që Rugova ishte
9 simbol i Kosovës për dhjetë vitet e para dhe mendoj që
10 ekzistonte kjo pikëpamje që unë duhej që të zgjeroja
11 horizontet e mia dhe ata dëshironin që unë të sigurohesha që
12 unë e dija vërtetë se çfarë cilësish kishte Rugova dhe fakti
13 që ata nuk e vlerësonin Rugovën në rrethanat e tyre dhe në
14 qarqet e tyre.

15 Unë po përpiqesha që të mos përfshiheja në biseda të
16 tilla në biseda të llojit që kush pëlqente kë në politikën apo
17 në qarqet e Kosovës. Unë personalisht isha i interesuar që të
18 hartohet ky projekti i parë i dokumentit ose të binim dakord
19 për pikat kryesore.

20 Më kujtohet ky takim i parë. Por nuk më kujtohet sepse
21 kam thënë që kemi qenë të ulur përtokë, përdhe sepse më
22 kujtohet që kemi qenë të ulur në disa stola. Megjithatë më
23 kujtohet që ata erdhën me armë dhe më kujtohet që i thashë që
24 ne nuk ndihemi rehat që të negociojmë me persona që kanë armë
25 në duar. Dhe ju kërkova që armë t' i linin jashtë shtëpisë.

1 Në qoftë se do më lejoni dua të shtoj edhe diçka tjetër,
2 nuk kuptoj plotësisht që unë përfaqësoja Qeverinë e Shteteve
3 të Bashkuara dhe po mundohesha që të bëja organizime politike
4 dhe ekzistonte prezumimi ose ideja që amerikanët ishin më
5 shumë emocionalisht të përfshirë në këtë çështje sesa ishim
6 realisht ose sesa duhet të ishim. Dhe për këtë arsye, unë ju
7 thashë që unë nuk dua të diskutoj në këtë takim pikëpamjet që
8 keni ju për Rugovën. Kur të organizoni zgjedhje të lira mund
9 të votoni kundër tij. Unë vërtetë u përpoqa që pjesëmarrësit
10 aty t'i përqendroja tek drafti tek versioni i parë.

11 PY. A ju krijua përshtypja që z. Thaçi foli në emër të
12 ndokujt në këtë takim?

13 PË. Jo, se nuk mendoj se z. Thaçi tha që përfaqësonte dikë
14 aty. Unë po arrija një pikë sa doja t'i kërkoja dikujt por nuk
15 është se besoja se mund të merrja mendim të sigurtë sepse
16 isha thjesht në pikën që doja t'i kërkoja personave që ishin
17 pjesëmarrës se çfarë mendimi kishin për draftin, për
18 dokumentin por nuk besoja që ata do të më thoshin përgjigjen e
19 sigurtë.

20 PY. A ju krijua përshtypja që z. Thaçi ishte një komandant
21 ushtarak?

22 PË. Jo.

23 PY. Çfarë përshtypje ju krijua për të atëherë?

24 PË. Ai fliste butë në mënyrë të mendueshme dhe mu krijua
25 përshtypja që ai më tepër ishte i përshtatshëm për një mjedis

1 universitar sesa për një mjedis ushtarak. Mua personalisht nuk
2 më kujtonte ndonjë mjedis ushtarak.

3 PY. A ju krijua përshtypja që z. Thaçi ishte një person në
4 kontroll të UÇK-së, domethënë, që e kontrollonte UÇK-në?

5 PË. Nuk kisha asnjë bazë për këtë. Ai ishte një prej tri
6 personave që erdhën. Ai ishte udhëheqësi i këtyre tre
7 personave që unë takova, por nuk mu krijua përshtypja që ai
8 ishte një person që kishte nën kontroll këtë organizatë të
9 madhe ose të drejtonte këtë organizatë të madhe. Nuk kishte
10 absolutisht asnjë lloj baze për këtë prezumim.

11 PY. Mesa ju kujtohet ju, a ju kujtohet që në këtë takim janë
12 diskutuar, keni diskutuar tema të cilat kishin të bënin me
13 persona që pretendohet të ishin rrëmbyer ose kidnapuar nga
14 UÇK-ja?

15 PË. Nëse do shohim veprimtaritë e ndryshme të UÇK-së, ishte
16 normale që të flitej për vrasjet ose për kidnapimet.

17 Megjithatë, mua nuk më kujtohen kidnapimet apo rrëmbimet si
18 një prej temave kryesore që kemi diskutuar sa i takon
19 rregullave të luftës. Por më kujtohet që kemi diskutuar për
20 çështje të cilat kanë të bëjnë me përfshirjen e punonjësve të
21 një impianti elektrik në veri në Kosovës dhe çfarë u kishte
22 ndodhur atyre dhe anëtarëve të familjeve të tyre, më pas, diku
23 nga dhjetori, u ngrit çështja e tetë ushtarëve serbë.

24 Megjithatë, në përgjigje të pyetjes tuaj, më lejoni të them që
25 nuk më kujtohet që konkretisht të kem marrë ose të kem

1 trajtuar, biseduar me ta çështje të kidnapimeve që duhet të
2 trajtohej në atë kohë.

3 PY. A ju kujtohet të keni diskutuar për tema të personave të
4 ndaluar në këtë takim?

5 PË. Jo, jo, në atë takim. Megjithëse çështja e personave të
6 ndaluar është diskutuar në përgjithësi, megjithatë, mua nuk më
7 kujtohet që të jetë diskutuar në takimin konkret për të cilin
8 po flasim.

9 PY. Do të thotë që nuk është diskutuar?

10 PË. Jo, nuk më kujtohet të jetë diskutuar. Përsëri dua të
11 theksoj që unë isha i përqendruar tërësisht për të kuptuar
12 sesi ndiheshin ata, pra, çfarë ndjesie kishin ata sa i takon
13 planit të Kosovës.

14 PY. A të ka thënë ndokush në ndonjë kohë në 1998 ose përpara
15 qershorit të 1999 që z. Thaçi mund të jetë përfshirë në
16 tortura ose në abuzime të tjera të të drejtave të njeriut?

17 PË. Jo, jo, asnjëherë, askush nuk e ka trajtuar këtë çështje
18 me mua.

19 PY. Takimi më 6 nëntor, a ju kujtohet në qoftë se Shaun
20 Byrnes ka marrë pjesë në këtë takim?

21 PË. Nuk më kujtohet. Më kujtohet që Tina Kaidanow ka qenë
22 aty. Por do kishte qenë logjike që Shaun të ketë qenë atje, po
23 thjesht mua nuk më kujtohet që ai ka qenë atje. Është diçka që
24 ka ndodhur 25 vite më përpara.

25 Nuk e di në qoftë se mund të ndryshoj përgjigjen që

1 dhashë pak më herët në qoftë se kam dëgjuar dikë që të thotë
2 diçka për Thaçin. I vetmi person që kam dëgjuar të thotë diçka
3 lidhur me këtë, po që ka qenë një koment më i përgjithshëm, ka
4 qenë Milosheviqi, askush tjetër.

5 PY. Bazuar në këtë përgjigje a është e saktë të themi që z.
6 Shaun Byrnes nuk ka sugjeruar asnjëherë juve që z. Thaçi ishte
7 i përfshirë në shkelje të të drejtave të njeriut?

8 PË. Jo, nuk më kujtohet që Shaun Byrnes të ketë sugjeruar një
9 gjë të tillë.

10 PY. Kthehemi tek çështja e Milosheviqit.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë tani
12 te libri që është aty i shfaqur në ekran tek faqja DHT12272.

13 Pak më poshtë ju lutem. Pak më poshtë deri në fund. Këtu. Po.

14 PY. Këtu thuhet -- diskutimi është për z. Milosheviq, që t'ju
15 japim kontekst. Pra, kur thuhet "Sa ishte ai i informuar"
16 bëhet fjalë për z. Milosheviq:

17 "Sa informacion kishte ai lidhur me marrëdhëniet me
18 shqiptarët? Ju përmendët një herë që ai mendonte se Bukoshi
19 kishte ushtrinë e vet, Rugova ushtrinë e vet dhe UÇK-ja
20 ushtrinë e vet. A kishte ai ndonjë informacion të vërtetë apo
21 thjesht po hamendësonte?"

22 Dhe përgjigja juaj është:

23 "Mendoj që ai hamendësonte shumë. Mendoj që ndonjëherë në
24 raste të caktuara mund të merrte ndonjë raport që mund të
25 ishte ose mund të mos ishte i besueshëm. Ai nxirrte përfundime

1 të tepërta në ato të dhëna. Pra, duke u bazuar në një raport.
2 Ai kishte një imagjinatë të vet, të llojit të vet. Më kujtohet
3 që ishte shumë i bindur thotë se ishte i bindur se Hashim
4 Thaçi ishte luftëtar i fortë i cili e kishte torturuar
5 personalisht njerëz dhe ishte përfshirë në shumë vrasje. Nuk
6 më kujtohet nëse ky, nuk e di nëse ky ishte kompliment për z.
7 Thaçi apo jo, por ai nuk është ka ai lloj personi.”

8 Pyetja ime është: Kjo pjesë që sapo lexuam a përputhet me
9 mënyrën sesi ju keni kuptuar si ishte z. Thaçi së pari?
10 PË. Jo, nuk është kështu. Sa i takon z. Milosheviq, fakti që
11 z. Milosheviq ka thënë këtë edhe pse nuk më kujtohet fjala
12 “luftëtar i ashpër, i fortë”, nuk më kujtohet ta ketë thënë
13 këtë, ta kem dëgjuar duke thënë këtë, nuk më kujtohet termi.
14 Por mendoj që mund të bëj një përmbledhje të komenteve të
15 Milosheviqit apo analizës së tij të shqiptarëve të Kosovës që
16 sipas tij përpiqeshin të ndikonin tek ne më shumë sesa të na
17 informonte.
18 PY. Faleminderit.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetic, në qoftë se --
20 Z. MISETIC: [Përkthim] Do ta qartësoj këtë, por në
21 rregull?

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në qoftë se do kaloni në
23 një temë tjetër a keni mundësi ta pyesni dëshmitarin që të
24 japë, t’i kërkojmë dëshmitarit të japë një datë apo datë të
25 përafërt lidhur me këtë kur ka ndodhur ky shkëmbim mes atij

1 dhe Presidentit Milosheviq.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë tek
3 faqja paraprake ju lutem.

4 PY. Atëherë, Ambasador Hill, tani ju dëgjuat pyetjen e
5 Gjykatësit Mettraux. A mund ta shikoni pak dokumentin në ekran
6 dhe nga konteksti kur mendoni se mund të ketë ndodhur kjo
7 bisedë juaja me z. Milosheviqin?

8 PË. Besoj që kjo duhet të ketë ndodhur në vjeshtë 1998, në
9 momentin kur Milosheviqi ishte gjithnjë e më shumë i
10 shqetësuar sepse mendonte se ne po largoheshim nga Rugova dhe
11 nga, pra, po largoheshim nga ndërveprimi jonë apo shkëmbimi që
12 kishim vetëm me z. Rugova dhe po përfshinim dhe UÇK-në dhe
13 mendoj që kjo ishte një përpjekje e Milosheviqit për të na
14 thënë neve që të mos punonim me UÇK-në. Dhe, pra, mendoj që
15 kemi shkuar në vjeshtë, kjo ka qenë në vjeshtë dhe ne e dinim
16 se kishim këtë gjë dhe filluam të takonim më shumë personazhe
17 nga strukturat e UÇK-së, pra, mendoj që ai ishte i shqetësuar
18 se ne po u jepnim atyre një rol më të spikatur në një
19 negociatë eventuale të ardhshme.

20 Pra, nuk kam përgjigje për pyetjen e Gjykatësit sa i
21 takon datës se kur ka ndodhur kjo, por mendoj që duhet të ketë
22 qenë tetor, nëntor, në atë periudhë kohore.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

24 DËSHMITARI: [Përkthim] Dhe duhet të shtoj që ky qëndrim i
25 Milosheviqit, pra, qëndrimi që ai kishte, që ata kishin,

1 mijëra negociatorë ishte qëndrimi i tij se shqiptarët, pra,
2 qëndrimi i tij ishte se shqiptarët nuk mund të mblidhen kurrë
3 së bashku dhe të bien dakord për asgjë. Ishte më shumë një
4 lloj ofendimi, sharjeje mbi baza etnike sesa një vlerësim i të
5 dhënave apo informacioneve.

6 Z. MISETIC: [Përkthim]

7 PY. Më lejoni të hyjmë në hollësi të kësaj. A ishte vlerësimi
8 jua i pohimit të tij të Milosheviqit pra, se Hashim Thaçi
9 ishte luftëtar shumë i ashpër apo ishte diçka e tillë, pra,
10 një gjë e tillë?

11 PË. Po. E dija që ai nuk ishte takuar kurrë me Hashim Thaçin
12 dhe isha i sigurtë që ai nuk ishte takuar kurrë me Hashim
13 Thaçi, pra, preferova që të kem gjykimin tim apo vlerësimin
14 tim të kësaj.

15 PY. Cili është ky gjykim?

16 PË. Që ai nuk ishte luftëtar i madh i ashpër. Nuk ishte
17 luftëtar. Ai ishte personazh politik i cili ishte mbështetur
18 në një kontekst që ishte më shumë historik dhe shkencë
19 politike sesa shkencë ushtarake, pra, vinte nga një e kaluar e
20 tillë.

21 PY. Dhe sa i përket pohimit, pohimit të Milosheviqit që ai
22 kishte personalisht vetë torturuar njerëz dhe që ishte
23 përfshirë në vrasje të shumta, në këtë pjesë ju më tej thoni:

24 "Nuk e di nëse ky ishte kompliment ndaj Thaçit apo jo,
25 por ai nuk është ky person."

Dëshmitari: Christopher Hill (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 68

1 PË. Jo vetëm që unë e vlerësova që ai nuk ishte ai lloj
2 personi siç e përshkruante Milosheviqi, por nuk kisha dëgjuar
3 këtë gjë nga askush. Mendoj që është e rëndësishme të kuptohet
4 e gjitha se gjatë gjithë kësaj periudhe unë kam qenë në
5 kontakt me z. Rugova dhe ai kishte mundësi të shumta dhe të
6 pafund që të denonconte njerëzit me emër, por nuk e ka bërë
7 këtë gjë.

8 PY. Faleminderit.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, do të kërkoj që të
10 paraqes për pranim në prova këto pjesë nga libri të cilat ia
11 tregova dëshmitarit dhe do të kërkoja që t'i shtohen provës
12 materiale 1D243 dhe kjo është pjesa DHT12287 deri në DHT12288
13 si dhe pjesën DHT12272 deri në DHT12273.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Pra, i pari është faqja DHT12287
16 deri në 88.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të parin e
18 kam si DHT12160 deri në 112169 në 12163.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Kjo është përmbledhja.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, ju nuk
21 po e paraqisni këtë si provë?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, faqja në
24 vijim është 12206 deri në 12372.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Kjo është pjesa e tërësishme, pra,

1 e librit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Thjesht më duhet.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faqja është
5 12272.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] 73.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 73?

8 Z. MISETIC: [Përkthim] 12272 deri në 73.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në 73. Në
10 rregull.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe kemi dhe një pjesë tjetër se
12 janë dy pjesë të ndara.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Cila është
14 pjesa tjetër?

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Ua tregova më herët. Është
16 DHT12287 deri në 88. Kjo ishte pjesa ku bëhej fjalë për
17 takimin me z. Thaçi në Dragobil.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thojeni dhe
19 në herë ju lutem.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Faqet të cilat kërkoj të paraqiten
21 për pranim si prova janë DHT12287 deri në DHT12288.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një sekondë
23 ju lutem. Në rregull.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Pjesa e dytë është DHT12273 deri
25 në DHT12273.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këto të dyja?

2 Atëherë DHT12272 deri në 73 pranohet.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të
4 nderuar Gjykatës. Këto dy faqe i shtohen provës materiale me
5 numër 1D4203.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe pjesa e
7 dytë është 12387 deri në 12388.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Këto dy faqe gjithashtu
9 do t'u shtohen provës materiale 1200423. Dhe janë të
10 klasifikuara si publike.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

12 Z. PACE: [Përkthim] A mund të qartësojë, thjesht të
13 sigurohemi që janë pranuar faqet e dhura dhe të sakta? Në
14 pjesën e dytë dëgjova Gjykatësin që tha 12387, por dëgjova
15 Avokatin që tha 122.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, është 12287.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

18 Z. MISETIC: [Përkthim]

19 PY. Z. Ambasador, Ambasadori Hill, kalojmë tani tek
20 Konferenca në Rambuje. Cili ishte roli dhe mandati juaj në
21 Rambuje, në Konferencën e Rambujesë?

22 PË. Unë po përpiqesha që të marrë që të dy delegacionet serbe
23 dhe kosovare të arrijnë të pajtohen, të bien dakord mbi një
24 tekst, dokument. Dhe që nga fillimi kjo duket si mision i
25 pamundur.

1 PY. Pse dukej mision i pamundur?

2 PË. Së pari, unë nuk isha i mendimit që ata të takoheshin në
3 konferencë së bashku në Rambuje. E dija që në Dejton, mbi
4 modelin e së cilit njerëzit u përpoqën të organizonin
5 Konferencën e Rambujesë, rrethanat dhe momenti kohor ishte
6 tërësisht ndryshe. Pra, nuk kisha, unë nuk udhëhiqesha nga
7 suksesi, suksesi relativ i Dejtonit, për të menduar që të
8 merrnim të arrijmë të njëjtin sukses në Rambuje.

9 Së dyti, dokumenti ishte bërë që i afrohej gjithnjë e më
10 shumë pavarësisë. Së pari, u përdor termi "i përkohshëm", pra,
11 në parim, i cili u paraqitë një apo dy javë përpara Rambujesë,
12 pra, duke patur nëse serbët do të angazhoheshin për këtë
13 dokument do ta pranonin këtë, fjala "e përkohshme" ishte bërë
14 një pengesë shumë serioze për ata. Së dyti, kolegët në
15 Ushington kishin shtuar se në një moment të caktuar kohor do
16 të bëhej një referendum në Kosovë mbi statusin e Kosovës
17 përfundimtar dhe e dija nga përvoja në Dejton, por e dija edhe
18 nga bisedat që kisha patur me serbët, që kjo nuk do të na
19 çonte askund.

20 PY. Faleminderit. A mund të na thoni kush e përfaqësoi aty
21 delegacionin shqiptar të Kosovës?

22 PË. Kishim tre grupe. Kishim grupin e LDK-së të udhëhequr nga
23 Ibrahim Rugova. Ai kishte më shumë një rol pasiv. Nuk ishte
24 pjesëmarrës aktiv, nuk fliste shumë gjë që ne e prisnim.

25 Pastaj kishim delegacionin e UÇK-së, ata ishin aktivë

1 bashkërisht në mënyrë kolektive, nuk mund të them që ndonjëri
2 prej tyre ishte më i spikatur se të tjerët. Pastaj kishim
3 intelektualët e pavarur. Është term ky që në Shtetet e
4 Bashkuara nuk do përdorej ky term, pra dhe ka shumë njerëz që
5 më pyesin po pse i referohesh dikujt si intelektual në një
6 konferencë të tillë, por kjo është një koment që po bëj lidhur
7 me kulturën amerikane besoj. Por në mesin e këtyre
8 intelektualëve të pavarur kishte persona të cilët kuptonin me
9 të vërtetë në mënyrë të mirëfilltë, pra, këtë gjë si, për
10 shembull, Blerim Shala, Rexhep Qosja i cili ishte aty si një
11 historian i madh i të drejtave të shqiptarëve në Kosovë.

12 Pra ishin tre grupe që formonin një delegacion, përbënin
13 një delegacion, por nuk funksionoi mirë.

14 PY. A e dini kush ishte kryetari i delegacionit?

15 PË. Mendoj që në emër ishte Rugova dhe pasi ishte më i vjetër
16 se të tjerët, pastaj ishte Rexhep Qosja dhe në krahun e UÇK-së
17 emri i Hashim Thaçit ishte i vetmi për të cilin kishim dijeni.
18 Por ne nuk ju jemi referuar njerëzve asnjëherë si kryesues të
19 delegacioneve sepse mendonim që thjesht do të përkeqësonte
20 problemet do t'i bënte dhe më të ashpra.

21 PY. Cili ishte thelbi i propozimit në Rambuje që Shtetet e
22 Bashkuara dhe anëtarë të tjerë të Grupit të Kontaktit po
23 propozonin?

24 PË. Kjo përfshinte krijimin e autonomisë së plotë për Kosovën
25 dhe në fund pastaj marrëveshja e Rambujesë përfshinte idenë e

1 një referendumi mbi statusin dhe të ardhmen në fund, pra,
2 përfundimtare. Dhe ajo që është dhe më e rëndësishme
3 përcaktoi, pra, aty u shpreh dhe u vendos ideja se NATO ishte
4 përgjegjëse për sigurinë në Kosovë. Dhe, pra, jo më tej, jo më
5 policia serbe apo njësitë ushtarake. Gjithashtu parimi që
6 mbështeste këtë ishte që të përpiqeshim që gjërat që bëheshin
7 sa më vendore që ishte e mundur, pra, sepse kjo ishte mënyra
8 sesi ne e kuptonim sesi funksiononte Kosova, se si udhëhiqej,
9 por ishte gjithashtu një mënyrë për të mbrojtur komunitetet
10 serbe sepse ajo që kuptohej ishte se kjo në qoftë se bëhej,
11 krijohet një shtet në Kosovë, komunitetet serbe do të donin të
12 largoheshin.

13 PY. Tani gjatë negociatave, a ndodhi në ndonjë moment kur
14 Shtetet e Bashkuara i kërkuan z. Hashim Thaçi që të pranojë
15 propozimin që i ishte vënë në tavolinë?

16 PË. Po. Dhe kjo ishte e rëndësishme sepse pikëpamja dhe
17 qëndrimi i ministrave të punëve të jashtme, dhe ata merrnin
18 pjesë në Rambuje herë pas here, jo gjithmonë, por qëndrimi i
19 tyre ishte në qoftë se një palë pranon marrëveshjen e
20 Rambujesë dhe pala tjetër nuk e pranon, ne do të mbështesnim
21 palën që kishte pranuar atë dhe të ishim kundër atyre që e
22 kishin refuzuar.

23 Pra, në qoftë se të dy palët pranonin dhe miratonin
24 marrëveshjen e Rambujesë, ne do të arrinim në një marrëveshje.
25 Por askush nuk ishte kaq optimist se kjo do të ndodhte.

1 Dhe, në fund, përfundimisht nëse të dy palët do ta
2 refuzonin, nuk do ta pranonin marrëveshjen atëherë do të
3 gjendeshin në situatën ku duhet të largoheshim, pra, nuk do
4 shkonim më tej. Unë isha gjithmonë, kam qenë gjithmonë skeptik
5 për këtë lloj qasjeje që ishte, pra, ose pranoje, merre ose
6 lërë këto lloj propozimesh, por kjo ishte sigurisht ideja,
7 pra, besimi, mendimi jonë ishte që nuk mund të arrinim që të
8 gjithë të pajtoheshin për këtë gjë.

9 PY. Z. Thaçi, a pranoi propozimin që ju ia vutë përpara?

10 PË. Jo, nuk e pranoi. Ai tregoi, shfaqti simpati për atë që po
11 bënim. Ai e kuptoi argumentimin e asaj që po bënim, do të
12 thotë, që thjesht nuk mund të jepet një propozim që funksionon
13 vetëm për njërën palë. Por shqetësimi i tij ishte se nuk ishte
14 në gjendje në pozitë që të pranonte një propozim që nuk vinte
15 fjalën pavarësi në dokument me terma të qartë.

16 PY. A ju kujtohet nëse ai ju tha juve, ju tregoi juve arsyet
17 se sepse nuk mund ta pranonte propozimin që nuk përfshinte
18 pavarësinë?

19 PË. Po, më kujtohet. Dhe ai e tha këtë në dy raste se po të
20 kthehej në Kosovë duke pranuar propozimin që nuk përfshinte
21 pavarësinë e Kosovës, ai do të vritej. Nuk e pyeta më tej se:
22 Nga kush, apo si, apo ku? Thjesht e kuptova këtë që ai nuk
23 ishte në pozitë për të thënë po.

24 PY. Faleminderit.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Sekretare e Gjykatës, mund të

1 shfaqni në ekran dokumentin DHT08797.

2 PY. E njihni këtë libër?

3 PË. Po.

4 PY. Ky është natyrisht libri juaj, Ambasadori Hill. Dhe në
5 qoftë se shohim paragrafin e dytë ju shkruani -- a mund të na
6 thoni kur është publikuar libri së pari?

7 PË. Libri është botuar në 2014.

8 Nuk dua të bëj reklamën e librit por libri përmban
9 informacione shumë nga Rambuje, Dejton, Koreja e Veriut,
10 Iraku. Pra, janë përvoja të ndryshme që kam patur si në
11 shërbimin e punëve të jashtme.

12 PY. Do të lexoj paragrafin e dytë, tretë dhe të katërt në
13 këtë faqe. Ku thotë, fillon me:

14 "Pak përpara pushimit ..."

15 Po flasim pushimin, pra, ndërprerjen e bisedimeve në
16 Rambuje:

17 "Pak para pushimit që do të ndodhte dy javë pas fillimit
18 të procesit, Thaçi që shkaktoi shqetësim tek ne u largua nga
19 konferenca më 18 shkurt dhe u kthye dy ditë më vonë me kërkesa
20 edhe më të ashpra. Ai nuk na tha, nuk tregoi asnjëherë se ku
21 kishte qenë, ku kishte shkuar edhe pse ne dyshonim që kishte
22 shkuar të takojë me z. Demaçi, pra, që ishte përfaqësuesi më
23 i flaktë i vetëmëruar si udhëheqës politik i UÇK-së, i cili
24 kishte refuzuar të merrte pjesë në Rambuje. Për muaj të tërë,
25 Demaçi kishte bërë fjalime të zjarrita, të tepruara shtypit në

1 Prishtinë në shkallë të tillë që serbët nuk ishin ndërhyrë
2 asnjëherë me të, ky ishte kontributi i tij për argumentin se
3 UÇK-ja ishte thjesht një grup radikalësh të çmendur.

4 “‘Pse nuk mund të pajtoheni me këtë?’ e pyeta Thaçin,
5 sepse me të vërtetë nuk e kuptoja nëse ai e kishte kuptuar
6 pasojat pothuajse fatale në rast se kosovarët do jepnin “jo”
7 si përgjigje.

8 “Dhe ai tha: ‘Ju jeni ai që nuk e kuptoni. Po të pajtohem
9 me këtë do të shkoj, do të kthehem në shtëpi dhe ata do të më
10 vrasin.’”

11 Po. A ju kujton diçka kjo pyetje?

12 PË. Po. Kur lexoja këtë paragrafin e dytë kam diçka që dua të
13 them, nuk doja të nënkuptoja që ai kishte shkuar të takoj me
14 z. Demaçi. Demaçi ishte figurë publike e këtij qëndrimi të
15 ashpër të panegociueshëm por nuk kam patur kurrë përshtypjen
16 udhëheqës i vetëshpallur, pra, si ky kishte në të vërtetë një
17 pozitë për t’i thënë dikujt ndonjë gjë. Pra, unë e kuptova
18 këtë që ishte më shumë si qëndrim kolektiv nga njerëzit që
19 ishin në Kosovë që ky nuk mund ta pranonte një gjë të tillë.

20 PY. Faleminderit.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, do të dorëzoj
22 faqen, kopertinën e librit që është DHT08787 deri në DHT09214
23 është pjesa në tërësi dhe ne do të dorëzojmë për pranim në
24 prova faqen HDT08787 deri në DHT08927.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

1 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT08787 deri
3 në DHT09214 në faqen DHT08927 pranohet.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Besoj se
5 ishin dy faqe? Dy faqe? Ballina dhe faqja që i paraqitëm
6 dëshmitarit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull. Këto dy
9 faqet do të marrin numrin e provës materiale 1D00425.
10 Klasifikimi është publik.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

12 PY. Ambasador Hill, si përfundoi Konferenca e Rambujesë në
13 shkurt të 1999?

14 PË. Fillimisht nuk dukej sikur ishte e suksesshme. Dukej
15 sikur të dyja palët e kishin refuzuar Marrëveshjen e
16 Rambujesë, kushtet e kësaj marrëveshjeje. Por ditë e fundit,
17 Veton Surroi, i cili kishte kapacitetin intelektual dhe
18 botëkuptimin ta kuptonte, ç'nënkuptonte refuzimi i kësaj
19 Marrëveshje të Rambujesë dhe e kuptoi se ky ishte shansi i
20 fundit për kosovarët, ju drejtua delegacionit kosovar dhe doli
21 me një propozim shumë të mirë të cilin ia dha ministrave të
22 jashtëm dhe tha: Ne shqiptarët e Kosovës e pranojmë propozimin
23 por duhet të kthehemi dhe t'ua paraqesim këtë propozim
24 popullit tonë.

25 Kështu që ne këtë morëm si pranim dhe ideja ishte që ne

1 do të mbështesnim delegacionin shqiptar. Sidoqoftë nuk u
2 nënshkrua marrëveshja dhe Veton Surroi sugjeroi dhe u pranua
3 që do të ktheheshin tre javë më pas ta nënshkruanin pasi të
4 kontaktonin popullin e tyre. Dhe kështu ndodhi në fakt. U
5 kthyen, u bë ceremonia e nënshkrimit në Paris kishte tre
6 përfaqësues që përfaqësonin tri grupet e ndryshme dhe këta
7 persona nënshkruan marrëveshjen dhe këtui përfundoi dhe
8 Rambujeja.

9 Ne e dinim që kishte filluar të kishte një përshkallëzim
10 dhune në terren prej serbëve dhe ne e dinim që me të ngjarë
11 kjo do të kërkonte që NATO të ndërmernte veprime.

12 PY. Faleminderit. A ju kujtohet kujt u drejtuan nga populli,
13 me cilët do konsultoheshin?

14 PË. Unë nuk e di me kë janë konsultuar në fakt, po kam
15 përshtypjen se ishte punë e tyre të takoheshin me grupe të
16 ndryshme. Në fakt jo një person konkret, jo domosdoshmërisht
17 një grup udhëheqësish me të cilët duhet të bisedonin, duhet të
18 shkonin nëpër bjeshkë nëpër zona të ndryshme të përpigeshin
19 "ta shisnin" marrëveshjen. Prandaj duheshin dhe tri javë.

20 Unë nuk e pata përshtypjen se nuk do të realizohej kjo.
21 Veton Surroi e kishte kuptuar se do t'u shpjegohej njerëzve
22 kjo marrëveshje, atëherë kjo marrëveshje do të pranohej. Pra,
23 në thelb kjo ndodhi në fakt. U kthyen në Kosovë, folën me
24 përfaqësues të ndryshëm të zonave. Nuk më kujtohet ndonjë të
25 më këtë thënë që "folëm me X dhe me Y". Nuk më kujtohet të më

1 kenë thënë ndonjë emër konkret udhëheqësi. Por ideja ishte të
2 kuptonin nëse kosovarët përgjithësisht do ta mbështesnin apo
3 jo këtë marrëveshje.

4 PY. Faleminderit. Në rregull.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarisë së seancës të
6 vendosë në ekran provën materiale P1076.

7 PY. Ambasador, ky është një kabllogram.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem shkojmë pak më poshtë që
9 të shohim ku është data. Apo lart? Më lart ju lutem. Këtu.

10 PY. E shihni datën?

11 PË. Shoh datën e deklasifikimit.

12 PY. Në të majtë.

13 PË. Ka qenë shkurt i 1999.

14 PY. Më duket se ka qenë 25.

15 PË. Po, 25.

16 PY. Poshtë fjalës konferencë?

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë tani më poshtë në tekst.

18 PY. Tek pika 1 thuhet:

19 "Me udhëzime të COM's sot pasdite shefi i KDOM-it Byrnes
20 e shtriu ftesën përmes zëdhënësit të UÇK-së Jakup Krasniqi, të
21 Krasniqit dhe anëtarëve të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm
22 Hashim Thaçi dhe Ramë Bujës. Krasniqi shprehu mirënjohjen për
23 ftesën dhe tha se UÇK-ja me kënaqësi e pranonte një ftesë prej
24 Shteteve të Bashkuara, prej Qeverisë së Shteteve të Bashkuara
25 ... tha se do të konsultohet menjëherë me kolegët për kohën po

1 do të ishte e parapëlqyeshme për delegacionin e UÇK-së të
2 shkonte në Washington menjëherë para ritakimit të Konferencës
3 së Rambujesë për shkak të problemeve që kishte tashmë
4 delegacioni i UÇK-së. Krasniqi tha që do ta kontaktonte sa më
5 shpejt Byrnes."

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim tani faqen tjetër.

7 PY. Pra, mesa kuptojmë i është bërë një ftesë UÇK-së të
8 shkojë në Uashington. Paragrafi 4 thotë:

9 "Ndërkohë që presim që të sqarohen ujërat, COM Miles", që
10 është shef i misionit, ky është?

11 PË. Po.

12 PY. "... Ambasadori Hill dhe shefi i KDOM-it Byrnes po ashtu
13 besojnë se është e rëndësishme që të përfshihen komandantët
14 ushtarakë në këtë delegacion. Ata janë pikërisht personat që
15 duhet ta kuptojnë se ç'nënkupton tranzicioni i UÇK-së në
16 institucione demokratike. Në pritje të rezultateve të
17 diskutimeve të brendshme aktuale të UÇK-së, rekomandojmë që të
18 ndiqet, që të merren parasysh - më falni - komandantët
19 ushtarakë të UÇK-së si pjesë të delegacionit.

20 "Komandanti i ri i UÇK-së, Sylejman Selimi, ndryshe
21 Sulltani. Selimi dikur ka drejtuar zonën kryesore të Drenicës
22 në Kosovë, në pjesën qendrore të Kosovës dhe është një nga
23 themeluesit e UÇK-së. Pretendohet që është shumë afër me
24 Hashim Thaçin ..."

25 Vijon më poshtë teksti.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Më poshtë ju lutem.

2 PY. "Remi dhe Selimi konsiderohen komandantët më të
3 rëndësishëm të UÇK-së. Edhe është nga kundërshtarët kryesorë
4 të Rambujesë."

5 Pra, a jua rifreskon kujtesën kjo për një udhëtim në
6 Uashington dhe propozimi që është bërë për të përfshirë disa
7 komandantë në mënyrë që të ishin në krahun tuaj?

8 PË. Duhet kuptuar kjo, këto kanë qenë propozime që janë bërë
9 prej Shaun Byrnes. Shaun Byrnes na ka propozuar kush ishte
10 lojtar kryesor, kush duhej bindur. Udhëtimi drejt Uashingtonit
11 apo udhëtimet drejt Uashingtonit përgjithësisht janë si një
12 mënyrë për t'i zbutur në marrëveshje të ndryshme. Ndodhin
13 shpesh në situata diplomatike, pra, nuk është e pazakontë të
14 kesh udhëtime të këtij lloji.

15 Por më duhet të them se disa prej këtyre propozimeve
16 tregojnë se ka më shumë strukturë se ç'besoj unë se kishte në
17 realitet. Për mua këta ishin thjesht persona, individë që
18 duhej t'i bindnim dhe nëse duhet t'i sillnim në Uashington për
19 t'i bindur atëherë kështu u bëftë, por nuk jam tërësisht
20 dakord me përshkrimet këtu se kush kanë qenë në realitet dhe
21 se çfarë kanë bërë.

22 Nëse punon në Shtëpinë e Bardhë, do të hezitoje që
23 persona të tillë të takonin presidentin, nëse ishte kjo ideja
24 fillestare, ndonëse nuk përmendet këtu. Por duhet parë, kjo ka
25 qenë thjesht një ide që të përpiqeshim që Kosova t'i thoshte

1 po marrëveshjes dhe kjo është një analizë për të kuptuar se
2 kush ishin lojtarët kryesorë dhe sesi mund t'i bindnim këta
3 persona që të merrnim një po.

4 PY. Në rregull. Shohim një dokument tjetër.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem shohim në ekran
6 materialin me numër DHT05401-DHT05405.

7 PY. Ambasador, ky është një raport i OSBE-së i 25 shkurtit
8 1999. Dy ditë pas përfundimit të bisedimeve të Rambujesë.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen 3 të dokumentit
10 DHT05403.

11 PY. Ku thuhet tek pika 2, "Zhvillimet në zonën e misionit",
12 paragrafi i dytë poshtë 2, ku thuhet:

13 " Zyra e Adem Demaçit, një përfaqësues politik i UÇK-së
14 deklaroi anulimin e marrëveshjes të dakordësuar nga delegatët
15 e shqiptarëve të Kosovës në Rambuje për të formuar një qeveri
16 të përkohshme të drejtuar nga anëtarët e UÇK-së. Agjencia e
17 lajmeve në Kosovë, Kosova Press, raportoi se anëtarët e
18 delegacionit vendosën më 23 shkurt se qeveria do të
19 administronte provincën deri sa të mbaheshin zgjedhjet.
20 Marrëveshja u nënshkrua mes UÇK-së, LDK-së dhe Lëvizjes
21 Demokratike të Bashkuar, LBD, Lëvizjes së Bashkuar
22 Demokratike. Të tri organizatat do të kenë përfaqësi të
23 barabartë në qeveri dhe UÇK-ja me marrëveshje të përbashkët do
24 të caktojë kryeministrin. Megjithatë, zyra e Adem Demaçit tha
25 në një deklaratë se një qeveri e tillë nuk do të ishte

1 legjitime dhe do të ishte 'një përpjekje e dështuar nga
2 personat që dolën nga negociata të pasuksesshme të Rambujesë
3 në mënyrë që të mundohen të fshehin dështimin e kësaj
4 marrëveshjeje'. Zyra thoshte se vendimi për të formuar një
5 qeveri është në kundërshtim tërësisht me parimet që ka
6 vendosur shtabi i UÇK-së. Koha Ditore thotë që zyra e Demaçit
7 ka thënë se 'ky akt po ashtu provokon dhe manipulon opinionin
8 kosovar që këta të fundit të pranojnë një marrëveshje që është
9 e pafavorshme për popullin e Kosovë.'"

10 Ju nuk e keni parë këtë më përpara, apo jo?

11 PË. Jo.

12 PY. Sjellja e Adem Demaçit, sikurse përshkruhet në këtë
13 artikull, a përputhet me sjelljen e Adem Demaçit gjatë
14 negociatave të Rambujesë?

15 PË. Po. Dhe çdo herë tjetër që kemi biseduar me të madje.

16 PY. Asokohe keni pasur dijeni ju se UÇK-ja, LDK-ja dhe LBD-ja
17 në ditën e fundit të konferencës vendosën të formonin një
18 qeveri të përkohshme?

19 PË. Po, isha në dijeni. Po të jem i singertë ka qenë një
20 problematikë e vazhdueshme që kanë pasur ata asokohe lidhur me
21 LDK-në dhe unë vijoja t'u thosha, unë vazhdoja t'ju thoja që
22 ky është një problem i juaj i brendshëm. Ne na duhet
23 marrëveshja për kushtet e Rambujesë.

24 PY. Sipas këtij artikulli z. Demaçi ka thënë që ky akt, pra,
25 formimi i qeverisë së përkohshme të Kosovës manipulon

Dëshmitari: Christopher Hill (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 84

1 opinionin kosovar që të pranojë një marrëveshje të pafavorshme
2 për popullin e Kosovës. Asokohe sipas teje formimi i qeverisë
3 së Kosovës do të ndikonte tek personat që e kundërshtonin fort
4 marrëveshjen në Kosovë?

5 PË. Unë i kam parë këto problematika dhe më përpara, formimi
6 i qeverive të përkohshme, sipas përvojës sime, më shumë ka
7 krijuar probleme sesa zgjidhje. Unë nuk isha shumë pro këtij
8 procesi dhe Demaçi mendonte që kjo ishte një mundësi që do të
9 shkurahejshin persona që përpigeshin vërtetë të bënin diçka.
10 Dhe pikërisht sjellja e tij për mua ishte tregues që nuk duhet
11 të vepronim në këtë mënyrë, nuk do t'i zgjidhnim problematikat
12 në këtë mënyrë.

13 PY. Faleminderit. Në rregull.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj pranimin e këtij materiali.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
16 kundërshtime?

17 Z. PACE: [Përkthim] Jo, nuk ka kundërshtime.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
19 Materiali DHT05401-DHT05405 pranohet. Mund t'i jepni numrin
20 përkatës.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Dokumenti
22 do të marrë numrin e provës materiale 1D00426 dhe klasifikimi
23 është konfidencial.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

1 Z. MISETIC: [Përkthim]

2 PY. Ambasadori Hill, ju keni pasur mundësi të shkoni në
3 Kosovë pas Marrëveshjes në Rambujesë, përpara se të
4 nënshkruhej në Paris?

5 PË. Po, kam shkuar. Dhe kam shkuar pikërisht që të krijoja
6 një ide -- ose do ta them ndryshe, ideja ishte të konfirmoja
7 përshtypjen tonë se përgjigja prej tyre do të ishte pozitive.

8 PY. Në atë udhëtim a takuat ndokënd prej UÇK-së?

9 PË. Po, por nuk kujtohet konkretisht kush, por e di që nuk ka
10 qenë Hashim Thaçi.

11 PY. Në rregull.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim në ekran materialin me
13 numër 1D310.

14 PY. Ky është një raport që shërbimet hulumtuese që tregon një
15 kronologji të konfliktit të Kosovës nga shtatori 1998 deri në
16 mars të 1999.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe më konkretisht shohim faqen
18 DHT02874. Shohim pjesën ku është data 8 mars 1999.

19 PY. "Pas një takimi të gjatë me dërguarin e SHBA-së në
20 Prishtinë, Christopher Hill, UÇK-ja u pajtua që të pranonte
21 kushtet e Marrëveshjes së Rambujesë."

22 Data është e saktë, pra, 8 mars 1999, a është data e
23 saktë?

24 PË. Pak a shumë. Po unë jam më shumë i fokusuar tek kjo pjesa
25 ku thuhet UÇK-ja u pajtua. Mua më kujtohet që më shumë ka qenë

Dëshmitari: Christopher Hill (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 86

1 në favor, është e ekzagjeruar kjo.

2 PY. Më intereson data.

3 PË. Më duhet ta shoh. Mund të jetë e saktë, po, duhet të jetë
4 e saktë.

5 PY. Në rregull. Ju thoni që nuk jeni i sigurtë këtu nëse UÇK-
6 ja ka rënë dakord që ta pranonte.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar z. Kryegjykatës, a mund
8 t'i rifreskoj kujtesën dëshmitarit?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E pyetët?

10 Z. PACE: [Përkthim] Dhe ne s'e kemi të qartë tani.

11 Dëshmitari harroj ndonjë gjë? Pse duhet t'i rifreskohet
12 kujtesa dëshmitarit?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse e ka
14 harruar mund t'ia rifreskoni kujtesën.

15 Z. PACE: [Përkthim] Më falni, po dëshmitari nuk tha që e
16 kam harruar. A mund ta sqarojë Avokati ju lutem?

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

18 Z. MISETIC: [Përkthim]

19 PY. Ju lutem shihni paragrafin 39 të deklaratës suaj. Nëse
20 doni mund ta vendosim në ekran. Doni ta lexoni apo t'ua lexoj
21 unë?

22 PË. Lexojeni ju, ju lutem.

23 PY. Thuhet:

24 "Gjatë këtyre tri javëve Hill shkoi në Kosovë dhe u takua
25 me protagonistë të ndryshëm. Sikurse thuhet në kronologjinë e

Dëshmitari: Christopher Hill (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 87

1 SHBA-së ... më 8 mars 1999, pas një takimi të gjatë me Hill në
2 Prishtinë, UÇK-ja ra dakord të pranonte Marrëveshjen e
3 Rambujesë. Ai mendon se ata vendosën ta pranonin sepse
4 garantonte përfshirjen e NATO-s."

5 Z. PACE: [Përkthim] Me gjithë respektin, unë bëra një
6 parashtrim përpara dëshmitari nuk iu përgjigj pyetjes.
7 Dëshmitari ka dhënë një përgjigje të ndryshme nga ajo që ka
8 thënë në përmbledhjen e vet dhe tani Avokati po kundërshton
9 pikërisht atë që ka thënë dëshmitari. Dëshmitari nuk tha që
10 nuk e mbaj mend. A do ta kapi gabim Avokati dëshmitarin?

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Cilado të jetë arsyeja ime, unë
12 kam të drejtën time ta bëj sipas rregullës 143.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

14 DËSHMITARI: [Përkthim] Mbj mend që ka pasur reagim të
15 favorshëm. Pra, ishte e favorshme, por, si zakonisht, askush
16 nuk kishte, nuk shprehte një vendim të qartë. E kuptoj pse
17 është thënë këtu që UÇK-ja ra dakord ta pranonte, por nuk më
18 kujtohet të ketë qenë kaq e qartë.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit.

20 PY. Ju na thatë që ju nuk besoni se ka qenë i pranishëm z.
21 Thaçi, kështu?

22 PË. Po, kështu.

23 PY. Mesa ju kujtohet ju, në takim a ju ka thënë ndokush se
24 nuk mund të merrni vendim përfundimtar për Marrëveshjen e
25 Rambujesë derisa të konsultoheni me z. Thaçi?

1 PË. Po më kujtohet kjo. Po përpigem të përdorë termat e duhur
2 -- nuk dua të them "gjuha trupore", pra, sipas gjuhës së tyre
3 trupore ishin në favor por askush nuk e shqiptonte dot dhe të
4 thoshte që, "Po, jemi dakord".

5 PY. Do ju tregoj një deklaratë që keni dhënë në intervistë
6 për Shalën.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem të shohim në ekran
8 materialin DHT12206-DHT12372 në faqen DHT12332. Shkojmë në
9 fund të faqes.

10 PY. Kjo është në kontekstin e këtij takimi për të cilin po
11 bisedonim pak më herët. Z. Shala ju pyet:

12 "Aktori kryesor atëherë ka qenë Thaçi. Pra, kur shkuar në
13 shtabin e UÇK-së pak a shumë u takuat me persona që ishin në
14 humor të mirë?"

15 Përgjigje:

16 "Mu duk sikur ishin pozitivë."

17 "Ishte pyetja ku është Thaçi ..."

18 Shala e ndërpret dhe thotë:

19 "... gjatë periudhës së parë ..."

20 Dhe ju përgjigjeni:

21 "Nuk e di a ju kujtohet, por Senatori Dole, ai u argëtua
22 shumë me këtë pyetje 'po ku është Thaçi?' Ata po më thonin
23 mua se Thaçi do të kthehej në Kosovë, në atë pikë dyshova, po
24 deri në atë pika kisha dyshuar, po pikërisht aty e pata të
25 qartë që Thaçi nuk ishte ndonjë nga komandantët kryesorë."

1 A përputhet kjo me pikëpamjen tuaj bazuar në këtë që keni
2 parë në këtë takim?

3 PË. Jo, nuk mund të them që s'është në përputhje. Po përpiqem
4 të gjej një formë. E di që Dole u mërziq që nuk po takohej me
5 Thaçin dhe publikisht po thoshte, "Po ku është Thaçi? Ku është
6 Thaçi?" Unë isha më shumë i interesuar nëse do ta pranonin apo
7 jo Rambujenë, sepse ishte pikërisht periudha që i paraprinte
8 nënshkrimit të Parisit. Ata ishin në humor të mirë, situata
9 dukej pozitive, atmosfera dukej pozitive.

10 Po sa i takon problematikës së dytë, që unë e mendoj si
11 problem më vete, për mua ishte e qartë në këtë pikë që z.
12 Thaçi nuk ishte ndonjë nga komandantët kryesorë. Pra, kjo
13 ishte, ky ishte realiteti. Komandantët ishin ata që ishin në
14 terren.

15 PY. Po çfarë ndodhi në këtë takim që ju çoi ju të dilnit në
16 përfundimin që nuk ishte nga komandantët kryesorë?

17 PË. Përgjigja kur na thanë që s'është këtu për mua ishte një,
18 nënkuptonte që ai kishte dalë të mblidhte opinione sikurse të
19 gjithë të tjerët, ai nuk ishte, pra, personi që do ta merrte
20 vendimin, duhet të merrte opinionin e të tjerëve.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkojmë pranimin e kësaj faqeje
22 DHT12332 dhe mund t'i bashkëngjitet provës 1D423.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
24 kundërshtime?

25 Z. PACE: [Përkthim] S'ka kundërshtime.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

2 Materiali 12332 pranohet dhe do t'i bashkëngjitet provës
3 1D423.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Kjo faqe
5 do t'i bashkëngjitet materialit 1D00423. Dhe klasifikimi është
6 publik.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë mund ta mbyll për sot.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Hill, për
11 sot përfunduar. Do të duhet të rifillojmë nesër në orën 9.00.
12 Do të përpiqemi që të fillojmë pikërisht në orarin e caktuar.
13 Mos flisni me askënd për dëshminë tuaj jashtë sallës së
14 gjyqit. E di që ju e dini këtë gjë, po unë duhet ta them
15 sidoqoftë.

16 Ju urojmë një mbrëmje të këndshme dhe mund të dilni nga
17 salla bashkë me Sekretaren e seancës.

18 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

19 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Për çështje planifikimi, mund t'ju
21 njoftoj rreth një gjysmë ore më ka mbetur për pyetjet e mia.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më pak se 30
23 minuta. Po ju të tjerët?

24 Z. DIXON: [Përkthim] Për momentin, nuk mendoj se do të
25 kem pyetje.

1 Z. ROBERTS: [Përkthim] Edhe unë jam në situatë të
2 ngjashme.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ellis.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Unë kam pyetje, po, por më pak se
5 ç'kisha kërkuar. Rreth 45 minuta besoj do më nevojiten mua për
6 pyetjet e mia.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
8 Faleminderit.

9 --- Seanca mbyllet në orën 16.59

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25